

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA KOSOVA /
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA - VLADA / GOVERNMENT
 MINISTRIA E EKONOMISE
 MINISTARSTVO EKONOMIJE
 MINISTRY OF ECONOMY

Nyena Org. 0113
 Org. Jedin. 4512
 Org. Unit
 No. i kopjeve 1
 Broj stranica
 No. pages

No. Prot. 4512
 Dato: 14.11.23
 Pristina A NO. 1



KOMPANIA REGIONALE DREJTORESI SH.A
 REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
 KOSOVO SH. DREJTORI MITROVICA
 MITROVICA
 YEL Post Box No. 1004
 Nr. 01-1524
 Dat: 27.10.2023

Plani i Biznesit 2024-2026

Vendimi i datës: (01-1524)

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt nr. 08-2023 të mbajtur me datë: 27.10.2023, pas shqyrtimit të Plani të Biznesit 2024-2026 në përputhje me pikën 26.14 të Kodit të Etikes dhe Qeverisjes Korporative për ndërmarrjet publike aprovoi Planin e Biznesit 2024-2026, dhe i njëjti Plan i dërgohet NJPMNP.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv: Bashkim Kurti	Kryesuese e BtD-së: Kumrije Kelmendi Aliu
Nënshkrimi		
Data	27.10.2023	27.10.2023



Faint text and markings on the left side of the page, possibly a list or notes.



1954-1955 Annual Report

Volume 1 (101-1234)

1954-1955 Annual Report of the National Security Agency, Volume 1 (101-1234). This report contains information on the activities of the Agency during the year 1954-1955. It is divided into two parts: Part I, General Information, and Part II, Special Information. Part I contains information on the Agency's organization, personnel, and activities. Part II contains information on the Agency's special projects and operations.

Date	Description	Page
1954-1955	Annual Report	1-100
1954-1955	Special Information	101-200



KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI “MITROVICA” Sh. A.



PLANI I BIZNESIT 2024 - 2026

*Rruga “Liqeni”, Suhodoll, 40000 Mitrovicë
www.kru-mitrovica.com*

Vizioni

Të kontribuojmë në ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës përmes ngritjes së cilësisë së shërbimit të ujit të pijes dhe mirëmbajtjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura, drejt arritjes së kënaqësisë të gjithë konsumatorëve tanë.

Misioni

Misioni ynë është që konsumatorëve tanë të tanishëm dhe atyre të ardhshëm të u ofrojmë shërbime të vazhdueshme dhe cilësore përmes ofrimit të ujit cilësorë të pijes dhe mirëmbajtës së sistemit të ujërave të ndotura dhe trajtimit të tyre, duke pasur gjithmonë në qendër të vëmendjes ruajtjen e shëndetit dhe ambientin përreth.

Filozofia

*Në qendër të vëmendjes kemi konsumatorin dhe besnikërinë e tyre e përfitojmë përmes ofrimit të shërbimeve cilësore në mënyrën më të mirë të mundshme,
Punonjësit tanë i çmojmë dhe u ndihmojmë në arritjen e potencialit të plot të tyre,
Me profesionalizmin tonë mundohemi që çdo veprim ta bëjmë me përsosshmëri,
Ne bëjmë më të mirën e mundshme për të ndihmuar shoqërinë tonë që vendin ku jetojmë ta bëjmë më të mirë për jetesë punë dhe zhvillim.*

Përmbajtja

1	HYRJE.....	1
1.1	Përmbledhja Ekzekutive.....	1
1.2	Historiku i Kompanisë.....	1
1.3	Objektivat Strategjike.....	3
1.4	Analiza SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet).....	4
2	SHËRBIMI ADMINISTRATIV.....	6
2.1	Plani i Menaxhimit të personelit.....	6
2.2	Zhvillimi Profesional dhe Trajnimet.....	6
2.3	Trajnimi për departamentin komercial.....	7
2.4	Trajnimi për departamentin teknik.....	7
2.5	Mjetet mbrojtëse në punë.....	8
2.6	Struktura organizative.....	9
3	SHËRBIMI FINANCIAR.....	11
3.1	Analiza e të Ardhurave.....	11
3.2	Analiza e Shpenzimeve.....	12
3.3	Provizionimi i Llogarive të Arkëtueshme (LL/A).....	13
3.4	Menaxhimi i Aseteve.....	14
4	SHËRBIMI KOMERCIAL.....	18
4.1	Leximi.....	18
4.2	Faturimi.....	18
4.3	Inkasimi.....	22
4.4	Plani për rritjen e numrit të konsumatorëve.....	25
4.5	Menaxhimi i kërkesave/ankesave të konsumatorëve.....	25
4.6	Plani për menaxhimin e leximit të ujëmatësve.....	25
5	SHËRBIMI TEKNIK.....	27
5.1	Hyrje.....	27
5.2	Mirëmbajtja e automjeteve (autoparku).....	28
5.3	Zbulimi i rrjedhjeve.....	28
5.4	Prodhimi & Operimi në Impiante.....	29

5.5	Mirëmbajtja e elektro makinerisë.....	29
5.6	Grumbullimi dhe trajtimi i Ujërave të Ndotura.....	29
5.7	Instalimi i ujëmatësve.....	30
6	STRATEGJIA E MARKETINGUT & MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	31
6.1	Qëllimi dhe Objektivat Strategjike.....	31
6.2	Marrëdhëniet me Publikun (PR).....	31
6.3	Komunikimi.....	32
6.4	Vetëdijësimi/Ndërgjegjësimi.....	32
6.5	Marketingu.....	32
7	PLANI I INVESTIMEVE	35
7.1	Lista e projekteve të planifikuara.....	35
7.2	Draft Lista e Projekteve të identifikuar në KRUM 2024 -2026.....	36
7.1	Draft Plani i Investimeve në 2024- 2026.....	38
7	PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM – SEKTORI GIS	44
7.1	Hyrje.....	44
7.2	Objektivat specifike për vitin 2024.....	45
7.3	Sfidat.....	45
8	CILËSIA E UJIT & burimet	46
8.1	Hyrje.....	46
8.2	Cilësia e ujit.....	46
8.3	SCADA.....	46
8.4	Analizat fiziko-kimike.....	47
8.5	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik.....	47
8.6	Burimet e ujit.....	48
9	SHTOICAT:	49

Lista e tabelave

Tabela 1 Ndarja e Buxhetit sipas departamenteve për trajnime për vitin 2024.....	8
Tabela 2 Niveli i edukimit/shkollimit të stafit të kompanisë 2022	10
Tabela 3 Pjesëmarrja gjinore e stafit të kompanisë 2022	10
Tabela 4 Të hyrat e planifikuara (me veri) të KRUM për vitet 2024– 2026	11
Tabela 5 Shpenzimet e planifikuara të KRUM për vitet 2023 – 2026.....	12
Tabela 6. Pasqyra e të ardhurave	13
Tabela 7 Plani i faturimit në m3 Mitrovicë.....	18
Tabela 8 Plani i faturimit në m3 - Vushtri	19
Tabela 9 Plani i faturimit në m3 – Skenderaj	19
Tabela 10 Plani i faturimit në m3 – Veriu i Mitrovicës dhe Zveçani	20
Tabela 11 Rekapitullimi i faturimit në m3 – KRU “ Mitrovica ” Sh.A.	20
Tabela 12 Plani i faturimit në Euro – Mitrovicë	20
Tabela 13 Plani i faturimit në Euro - Vushtri	21
Tabela 14 Plani i faturimit në Euro – Skenderaj.....	21
Tabela 15 Plani i faturimit në Euro – Veriu i Mitrovicës dhe Zveçan.....	22
Tabela 16 Rekapitullimi – Plani i Faturimit për 2024 KRU “ Mitrovica ” Sh.A.....	22
Tabela 17 Plani i Inkasimit për 2024 – Mitrovicë	23
Tabela 18 Plani i Inkasimit për 2024 – Vushtri	23
Tabela 19 Plani i Inkasimit për 2024 – Skenderaj.....	24
Tabela 20 Plani i Inkasimit për 2024 – KRU “Mitrovica” Sh.A.	24
Tabela 21 Numri i planifikuar i konsumatorëve sipas viteve.....	25
Tabela 22 Kapacitetet prodhuese të ITU-ve.....	29
Tabela 23. Strategjia e PR & Marketingut.....	33
Tabela 24. Aktivitetet dhe buxheti për Informim Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing.....	33
Tabela 25 Investimet kapitale 2024	35
Tabela 26 Projektet e Identifikuara	36

AKRONIMET

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencia Statistikore e Kosovës
BD	Bordi i Drejtorëve
CRM	Customer Relationship Manager (Softueri për Menaxhimin e Marrëdhënieve me Konsumatorin)
EDAMS	Dizajn Inxhinieringu dhe Sisteme të Menaxhimit (Engineering Design and Management Systems).
ITU	Impianti për Trajtimin e Ujit
ITUZ	Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
KRUM	Kompania Rajonale Ujësjetësi "Mitrovica"
LUXDEV	Luxemburg Development
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP	Ndërmarrje Publike
SWOT	Shkathtësitë, dobësitë, mundësitë, rreziqet(Stengths Weaknesses Oportunities Threats)

1.1 Përmbledhja Ekzekutive

Plani trevjeçar i biznesit është dokument bazë për menaxhimin e ndërmarrjes përmes planifikimit dhe përcaktimit të objektivave afatgjate i cili paraqet një udhëzues në lidhje me atë se ku qëndrojmë, ku dëshirojmë të shkojmë dhe si do të arrijmë atje. Plani i Biznesit ofron informatat e nevojshme si për menaxhmentin po ashtu edhe për Bordin e Drejtorëve të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" (KRUM) lidhur me afarizmin e ndërmarrjes duke ofruar informatat për vitin aktual – 2023, si dhe planifikimin e detajuar lidhur me afarizmin e ndërmarrjes për vitin 2024 –2026. Në plan shtjellohen dhe përshkruhen veprimet dhe aktivitetet tona bazuar edhe në strategjinë e ndërmarrjes me qëllim të ofrimit informatave të rëndësishme të cilat janë të domosdoshme për marrjen e vendimeve strategjike të zhvillimit.

Plani i Biznesit 2024 – 2026 është përgatitur në aspektin strategjik dhe operativ të tij nga Menaxhmenti Ekzekutiv i Kompanisë dhe i miratuar nga Bordi i Drejtorëve (BD) të Kompanisë. Duke respektuar Ligjin për Ndërmarrjet Publike në Kosovë, Plani i Biznesit i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë (ME) si dokument zyrtar informativ.

Plani i Biznesit përshkruan qëllimet, objektivat, strategjitë dhe aktivitetet e propozuara të cilat Kompania synon ti arrijë gjatë periudhës 2024 – 2026 si dhe planet e detajuara të veprimeve/aktiviteteve të cilat do të ndërmerren në mënyrë që të arrihet realizimi i çaveve të parapara në këtë plan.

Menaxhmenti i Kompanisë obligohet për implementimin e këtij plani dhe sipas nevoje edhe rishikimin dhe monitorimin e tij në baza të rregullta të parapara me ligj. Në afatin gjashtëmuor kompania do të bëjë rishikimin e planit me qëllim të përmbushjes së planit njëvjeçar të vitit vijues 2024, nisur nga fakti se ky Plan është përgatitur pa përfunduar viti i plotë paraprak (2023).

1.2 Historiku i Kompanisë

Ujësjellësi i Mitrovicës për herë të parë ka filluar punën në vitet e 40-ta të shekullit të kaluar dhe fillimisht kishte obligim furnizimin me ujë të pijes të rreth 20.000 banorëve. Kapaciteti prodhues asokohe ishte rreth 10 l/s, dhe ujin e papërpunuar e siguronte nga lumi Ibër. Trajtimi bëhej në mënyrë natyrale ku si filtra përdoreshin shtresat zallore përmes të cilave uji i trajtuar arrinte në pusët e hapura të cilat përdoreshin si rezervuarë të ujit të pijshëm.

Në vitin 1983 përfundon ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujit (ITU) në Shipol të Mitrovicës i cili fillimisht funksiononte me një kapacitet prodhimi prej 300 l/s.

Me rritjen e popullatës, rritet edhe kërkesa për ujë të pijes, kështu që në vitin 1986 Impianti zgjerohet me ç'rast rritet kapaciteti i trajtimit të ujit nga 300 l/s në 450 l/s. Që atëherë fillon furnizimi me ujë të pijes për komunitat Vushtrri dhe Skenderaj.

Në vitin 2011 për herë të parë lëshohet në funksion Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN), në Laushë të Skenderajt, model ky i pari i këtij lloji në Kosovë me një kapacitet për trajtimin e ujerave të ndotura prej 245 m³/h.

Me rritjen e popullatës dhe zgjerimin e rrjetit të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit, rritet edhe kërkesa për furnizim me ujë të pijes. Kështu lindi nevoja për zgjerimin e kapacitetit prodhues të Impiantit në Shipol. Zgjerimi i Impiantit për Trajtimin e Ujit nga 450 në 700 l/s ndodh në vitin 2014 falë donacionit të Bashkimit Evropian. Ky zgjerim kishte për qëllim sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë të pijshëm të konsumatorëve të Regjionit të Mitrovicës (Skenderaj, Vushtrri Veriu i Mitrovicës dhe Zveçani).

Rritja e vazhdueshme e kërkesave për ujë të pijes ndikon që të rriten kapacitetet prodhuese të ujit, prandaj në vitin 2016 në fshatin Balincë të Vushtrrisë përfundon ndërtimi i një Impianti të ri me një kapacitet prodhues prej 300 l/s, gjë që mjafton të furnizoj popullatën e Vushtrrisë me ujë të pijes.

Sot, Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh. A. funksionon si Ndërmarrje Publike e cila në kuadrin e saj ka rreth 260 punonjës, të ndarë në tri Njësi Punuese Operative: Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj.

Furnizimin me ujë të pijes dhe mirëmbajtjen e ujërave të ndotura e bënë në tërë Regjionin: Mitrovica (J) me 69.866 banorë; Vushtrria me 63.473; Skenderaj me 53.277 banorë; Mitrovicën (V) me 11.987 banorë dhe Zveçanin me 7.235 banorë¹. Ndërsa në Veri të Mitrovicës dhe Zveçan janë të furnizuar me ujë të pijes (me shumicë) por nuk mirëmbahet rrjeti i kanalizimit nga KRUM pasi që nuk kemi qasje në atë pjesë për shkak të situatës politike e cila kërkon zgjidhje politike.

¹ASK "Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2021"




Figura 1. Zona e mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit

1.3 Objektivat Strategjike

Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" operon si ndërmarrje e cila është llogaridhënëse tek Bordi i Drejtorëve, në përputhshmëri me principet e qeverisjes korporative.

Bordi i Drejtorëve, duke përfshirë Drejtorët Jo-ekzekutiv dhe Drejtorët/Zyrtarët Ekzekutiv, për të gjitha aktivitetet bazë, për një periudhë më afatgjatë (deri në 2026) ka përcaktuar qëllimet kryesore strategjike të cilat rrjedhin nga deklarata e nivelit të shërbimeve, përbushja e të cilave synohet të arrihet përmes:

- Zgjerimit të zonës së shërbimit,
- Mirembajtja e vetqendrueshmërisë financiare
- Furnizimit të rregullt dhe të pandërprerë me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët,
- Përmirësimin e vazhdueshëm të raporteve me konsumatorin në veçanti dhe publikun në tërësi duke qenë afër tyre.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të punës për të gjithë të punësuarit,

Në planifikojmë që qëllimet strategjike afatgjata të lartë-përmendura të i realizojmë duke shfrytëzuar burimet e Kompanisë por dhe përmes mbështetjes nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe donatorëve aktual por dhe atyre potencial. Kompania ka paraparë përbushjen dhe arritjen e objektivave

strategjike për vitin 2024 si vijon:

- Zvogëlimin e shkallës së ujit të pa faturuar në 44 %
- Mirëmbaj dhe përmirësoj cilësinë e ujit të pijes në nivele edhe më të larta,
- Mirëmbaj dhe investoj në rrjetin e ujit dhe kanalizimit me qëllim të ofrimit të një shërbimi sa më cilësor,
- Rritjen e shkallës së arkëtimit në 89 %
- Ngritjen e normës së punës në 1.20
- Rritjen e efikasitetit të stafit në 5.39

1.4 Analiza SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet)

Për realizimin dhe arritjen e objektivave të parapara në këtë Plan, kompania ka përdorur analizën SWOT dhe metodologjinë e katër faktorëve; fuqitë, dobësitë, mundësit dhe rreziqet. Këta faktorë kanë të bëjnë me rritjen e organizatës, produktet, shërbimet dhe objektivat e biznesit dhe konkurrencën e tregut. Dy nga këta faktorë janë të brendshëm: përparësitë dhe dobësitë dhe kanë të bëjnë me ndikimin e vetë kompanisë në suksesin e saj, kurse dy faktorët tjerë: mundësit dhe rreziqet paraqesin faktorët e jashtëm dhe të njëjtit varen nga ambienti i jashtëm i kompanisë. Për të arritur rezultatet e duhura KRUM do të tentoj të minimizoj dobësitë dhe rreziqet, duke përmirësuar në vazhdim teknologjinë e punës, avancuar/trajnuar stafin, qasje të vazhdueshme proaktive ndaj borgjlinjeve, etj., e poashtu të maksimizoj përparësitë dhe mundësit duke përmirësuar dhe zgjeruar në vazhdim shërbimin ndaj konsumatorit, duke ofruar mundësi zhvillimi profesional përmes punës praktike dhe punësimit për kuadrot e reja dhe profesionale.

1.4.1 Përparësitë:

- Përvoja shumëvjeçare në sektorin e ujësjellësit,
- Infrastruktura të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Treg të sigurt, konsumatorë të besueshëm, shitje të garantuar,
- Mbështetje nga Partnerët si: Qeveria, Komunitat, SHUKOS, ARRU, BE, CDI dhe donatorët tjerë,
- Mos prezencë e konkurrencës në sektorin operues,
- Kapacitete të mjaftueshme prodhuese; Impianti në Shipol dhe Balinc,

1.4.2 Dobësitë:

- Pajisjet e vjetërsuara dhe jo të përshtatshme me metodat bashkëkohore,
- Mosha e shtyrë e fuqisë punëtore,
- Konsumi i ujit në veri dhe mos pagesa e tij,

- Humbjet e mëdha teknike dhe komerciale,
- Sistemi Informativ Menaxhues (MIS),
- Borxhet e trashëguara të klientëve

1.4.3 Mundësitë:

- Zgjerimi i zonës së shërbimit dhe rritja e numrit të konsumatorëve,
- Zhvillimin e shërbimeve të reja lehtësuese për konsumatorin,
- Përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujit dhe kanalizimit,
- Bashkëpunimi me kompanitë e sektorit të ujit si brenda ashtu edhe jashtë shtetit, dhe shkëmbimi i përvojave,
- Bazë e mirë ligjore për procedim të lëndëve të ndryshme në Gjykatë apo përmes Përmbauesve Privat,
- Infrastrukturë ligjore nga ana e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU),
- Pjesëmarrje në konferenca vendore e rajonale përmes Shoqatës së Ujësjetësve të Kosovës (SHUKOS),
- Ngritja e kapaciteteve profesionale

1.4.4 Rreziqet:

- Ngritja e tensioneve sociale apo politike,
- Fatkeqësitë natyrore (tërmetet, vërshimet etj.),
- Shfaqja e ndonjë pandemie të re.
- Trendi i ikjes së fuqisë punëtore si pasojë e liberalizimit të vizave për Kosovë
- Gjendja e vështirë ekonomike dhe niveli i lartë i rasteve sociale në regjionin e Mitrovicës

2 SHËRBIMI ADMINISTRATIV

2.1 Plani i Menaxhimit të personelit

Ujësjetllësi "Mitrovica" në Mitrovicë, tërë procesin e përpunimit, shpërndarjes, shërbimit me ujë të pijshëm dhe mënjanimin e ujërave të ndotura, synojmë që të mbajmë numër relativisht të qëndrueshëm të punëtorëve dhe që reflekton në zgjerimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve, e cila rritje apo zgjerim duhet të reflektoj edhe në rritjen e numrit të punëtorëve, numër i cili parashikohet të jetë prej 260-285 në periudhën 2024-2026 për të siguruar efikasitetin e kompanisë.

Burimet Njerëzore pranë K.R.U "Mitrovica", aktivitetet e tyre i realizojnë në bazë të direktivave paraprakisht të përcaktuara në kuadër të Departamentit të Administratës me të vetmin qëllim realizimin e vizionit dhe misionit të kompanisë. Burimet Njerëzore janë njerëzit duke përfshirë (diturinë e tyre, aftësitë dhe shkathtësitë), të cilët kryejnë punët konkrete brenda kompanisë.

Vizioni i Burimeve Njerëzore, është të ketë një sistem funksional dhe modern në harmoni të plotë me zhvillimet e kohës.

Njësia e Burimeve Njerëzore kanë për qëllim që në mënyrë efektive t'i shtoj vlerat e kompanisë duke bërë:

- Zhvillimin dhe menaxhimin efektiv të punonjësve,
- Lidhjen dhe vlerësimin e performancës dhe kompensimit adekuat,
- Zhvillimin e kompetencave që rrisin performancën individuale dhe organizative,
- Rritjen e inovacionit, kreativitetit dhe fleksibilitetit të nevojshëm për të rritur konkurrencën,
- Planifikimin e zhvillimit të karrierës dhe lëvizshmërinë ndër organizative,
- Menaxhimi i zbatimit dhe integritit të teknologjisë përmes përmirësimit të sistemit, stafit, trajnimit dhe komunikimit me punonjësit.

2.2 Zhvillimi Profesional dhe Trajnimet

Burimet Njerëzore për ujësjetllësin paraqesin asetin kryesor të kompanisë dhe të njëjtin e çmojmë dhe vlerësojmë për punën dhe angazhimin e tyre drejt realizimit të qëllimeve të tyre individuale me çka arrijmë edhe përmbushjen e objektivave kolektive të kompanisë sonë. Në këtë aspekt, ujësjetllësi planifikon që në vazhdimësi të investoj në ngritjen dhe zhvillimin e të punësuarve të saj, duke organizuar trajnime profesionale për ta. Roll i trajnimeve ka për qëllim të rekomandoj, hartoj, zhvilloj dhe zbatoj programe inovative të mësuarit dhe zhvillimit që mbështesin ciklin e plotë të punësimit, duke përfshirë hyrjen në kompani, zhvillimin

e karrierës, mirëqenien, planifikimin e vazhdimësisë dhe zhvillimin e menaxhimit dhe lidërshiptit. Identifikon, zhvillon dhe ofron trajnime në përdorimin e burimeve dhe teknologjive online për të mbështetur zhvillimin organizativ. Trajnimit të vazhdueshëm të stafit do ti kushtohet një kujdes i veçantë ndërsa kosto e këtyre është paraqitur në buxhetin e përgjithshëm në kategorinë e shpenzimeve të personelit.

Në vazhdim paraqesim sferat në të cilat do të fokusohemi në planin e trajnimeve për vitet në vazhdim:

Trajnimi i punonjësve në administratë:

- Trajnime për ndryshimet/përditësimet/ risit e ligjeve për zyrtarët ligjor,
- Trajnime në lidhje me vlerësimin e performancës së stafit,
- Trajnimi mbi zhvillimin e burimeve njerëzore,
- Trajnimi rreth ligjit dhe procedurave arkivore etj.

Trajnimi i të punësuarve nga mbrojtja shëndetësore dhe sigurimi fizik

- Trajnim dhe certifikimi për mbrojtje kundër zjarrit;
- Trajnimi dhe certifikimi për ndihmën e parë dhe mbrojtja në punë,

Trajnimi i punonjësve në financa

- Përditësim i vazhdueshëm dhe trajnim për tatimet dhe prezantimin e Pasqyrave Financiare nga ana e ATK-së,
- Trajnime në lidhje me Menaxhimin e Aseteve,,
- Trajnime mbi regjistrimin e inventarit dhe depos,

Trajnimi në Njësinë e Auditimit

- Përditësim i vazhdueshëm dhe Trajnim për standardet e Auditimit të Brendshëm,
- Përditësim i vazhdueshëm dhe trajnim për ligjet e aplikueshme në tatime, pasqyrat financiare, prokurim etj.

2.3 Trajnimi për departamentin komercial

- Trajnime për marrëdhënie dhe komunikim efektiv me konsumatorin,
- Përditësim i vazhdueshëm dhe trajnim në zbatimin e Rregulloreve të KRUM,

2.4 Trajnimi për departamentin teknik

- Parashihet që gjatë 3 viteve të ardhshme të bëhen trajnime të teknikës për, ITU, ITUN dhe të punonjësve të njësive operative. Këto trajnime duhet të kryhen sidomos në sistemin SCADA, elektro -

makineri, saldime, instalim dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujit dhe kanalizimit, trajnime për Auto CAD dhe modelime të rrjetit (Model Builder).

2.5 Mjetet mbrojtëse në punë

Siguria në punë e punonjësve paraqet jo vetëm obligim ligjor por edhe moral, prandaj fokusi ynë do të përqendrohet në krijimin e kushteve edhe më të sigurta në vendin e punës. Në këtë drejtim do të sigurojmë:

- Pajisjen e vazhdueshme të punësuarve me mjete bashkëkohore mbrojtëse në punë,
- Pajisjen me aparate kundër zjarrit dhe servisimin periodik të tyre,
- Kontrollat periodike, mjekësore - sanitare,
- Mjetet e tokëzimit dhe rrufepritëseve në objektet tona,
- Pajisja me mjete sinjalizuese për punët në rrugë,

Të gjitha këto masa mbrojtëse të sigurisë do të ndikojnë në parandalimin e aksidenteve në vendin e punës dhe rritjen e sigurisë në vendin e punës.

Tabela 1 Ndarja e Buxhetit sipas departamenteve për trajnime për vitin 2024

TRAJNIMI	BUXHETI/€
Departamenti Administrativ	2500
Departamenti Teknik	3200
Departamenti Komercial	3000
Departamenti Financiar	1300
Njësia e Auditimit	500
Totali i Përgjithshëm	10,500

2.6 Struktura organizative




Figura 2. Struktura organizative

Skema organizative e paraqitur në këtë kapitull është e modelit të piramidës në bartjen e kompetencave, përgjegjësisve dhe autorizimeve nga "lartë-poshtë" dhe kryerjen dhe raportimin e përbushjes së të njëjtave nga "poshtë-lartë". Skema organizative aktuale është miratuar nga BD të KRUM-së 27.12.2022. Skema mund të ndryshojë vetëm në rast të ndryshimeve të domosdoshme. Nga kjo shihet se KRU "Mitrovica" Sh.A. udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Zyrtarët e Lartë: Kryeshefi Ekzekutiv, Auditori i Brendshëm, Zyrtari Kryesor Financiar dhe Sekretari i Korporatës / Këshilltari i Përgjithshëm. Grupi udhëheqës i kompanisë përbëhet nga Kryeshefi Ekzekutiv, i mbështetur nga ekipi i tij i udhëheqjes, gjegjësisht nga Drejtorët e Departamenteve. Janë katër (4) Departamente Organizative në kuadër të Kompanisë si më poshtë:

1. Departamenti Administrativ
2. Departamenti Financiar
3. Departamenti Komerçial dhe
4. Departamenti Teknik

KRU "Mitrovica" Sh.A. është një kompani publike nën administrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila njëkohësisht është edhe aksionare e Ndërmarrjes. Në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, bazohet në legjislacionin, Ligjet në fuqi në Kosovë, aktet nënligjore si dhe Rregulloret e brendshme të Kompanisë të hartuara në bazë të ligjeve në fuqi në Kosovë. Kompania, aktualisht numëron 259 punëtor të përqendruar në tri njësitë e saja operative: Mitrovicë, Vushtri dhe Skenderaj. Në tabelën në vazhdim kemi ilustruar hollësisht strukturën e punonjësve tanë.

Tabela 2 Niveli i edukimit/shkollimit të stafit të kompanisë 2022

Edukimi	Nr. i stafit	Përqindja
Edukimi pakualifikuar/filior	23	8.8 %
Edukimi i mesëm/ lartë	176	67.95 %
Fakultet / Bachelori	35	13.5 %
Master	22	8.4%
Totali	259	100%

Ndërsa tabela e mëposhtme pasqyron ndarjen e punonjësve në baza gjinore në kompani. Nga kjo shihet se vetëm 10.03 % e punonjësve janë gra, kurse 89.97% burra.

Objektivi i Burimeve Njerëzore është plotësimi i nevojave për të rritur pjesëmarrjen e grave në kompani, duke u mbështetur në strategjinë e ndërmarrjes dhe biznesit të saj, përkrahja e politikave dhe praktikave të punësimit, adaptimit dhe integritit të burimeve njerëzore, duke zbatuar politikat e zhvillimit të tyre si dhe krijimi i hapësirave dhe mundësive të punëtorëve në mënyrë të vazhdueshme.

Tabela 3 Pjesëmarrja gjinore e stafit të kompanisë 2022

Gjinia	NUMRI I PUNONJËSVE	PËRQINDJA%
Grë	26	10.03%
Burra	233	89.9%
Total	259	100.00%

3 DEPARTAMENTI FINANCIAR

Departamenti Financiar gjatë përpilimit të Planit të Biznesit ka paraparë sfidat me të cilat do të ballafaqohet gjatë periudhës planifikuese. Në këtë kontekst para vetes kemi vendosur objektivat të cilat për ne paraqesin objektiva të vazhdueshme:

- Rivlerësimi i aseteve (nëntokësore dhe mbitokësore) nga një kompani e licencuar,
- Provizionimi i llogarive të arkëtueshme,
- Përpilimi i pasqyrave financiare në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK),
- Raportimi financiar për qëllime tatimore të jetë në harmoni me ligjet në fuqi të ATK-së
- Evidentimi dhe bartja e pronave në emër të KRUM,

Plani financiar i afarizmit për vitin 2024 është bërë në bazë të vlerësimit të realizimit të planit deri në 30.09.2023, për vitin 2023 si dhe në bazë të parashikimeve për aktivitetet të cilat do të ndodhin në vitin 2024. Duhet theksuar se parashikimet e bëra në kushtet aktuale është vështirë të planifikohen dhe të njëjtat të paraqiten për periudhën njëvjeçare duke pasur parasysh se ende nuk ka përfunduar viti afarist 2023.

Të hyrat të cilat do të jenë përcaktuese të rezultateve financiare në vitin 2024 do të jenë të hyrat nga shitja e ujit, mirëpo të hyra do të ketë edhe nga ofrimi i shërbimeve tjera në rrjetin e ujit dhe kanalizimit.

3.1 Analiza e të Ardhurave

Të ardhurat të cilat kompania ka paraparë për vitet në vazhdim në pjesën më të madhe do të vijnë nga shitja e ujit. Vlera e të hyrave të planifikuara për vitin 2024 është bërë bazuar në tarifën e përcaktuar nga ARRU.

Si kriter për parashikimin e rritjes së të ardhurave janë marrë edhe të dhënat historike nga vitet paraprake dhe sfidat e problemet me të cilat kompania është ballafaquar krahas realizimit të hyrave.

Tabela 4 Të hyrat e planifikuara (me veri) të KRUM për vitet 2024–2026

Emërtimi	2023 (aktuale)	2024	2025	2026
	(EUR)	(EUR)	(EUR)	(EUR)
Faturimi	5,356,514	5,505,999	5,616,119	5,672,280
Arketimi	4,524,066	4,922,326	5,069,996	5,222,096
% Arketimit	84%	89%	90%	92%
Te hyrat nga shërbimet	93,483	90,000	91,000	91,500
% Arketimit për shërbime	100%	100%	100%	100%

Norma e planifikuar e arkëtimit për vitin 2024 është paraparë të arrijë shkallën prej 89% të shumës së faturuar.

3.2 Analiza e Shpenzimeve

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2024 është bërë me kujdes dhe për bazë janë marrë faktorët të cilët potencialisht do të mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen e shpenzimeve operative të kompanisë. Këtu mund të përfshihet rritja graduale e çmimeve të cilat bazohen në shkallën vjetore të inflacionit, është paraparë rritje e lehtë e pagave për stafin dhe reduktim i shpenzimeve të tjera

Në vazhdim po paraqesim planin e detajuar të shpenzimeve të planifikuara për vitet 2024 – 2026 për disa nga elementet kryesore të shpenzuesve më të mëdhenj dhe të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejt në performancën e kompanisë.

Tabela 5 Shpenzimet e planifikuara të KRUM për vitet 2023 – 2026

KATEGORIA	Vitet			
	Faktike & Buxheti 2023	Buxheti 2024	Projektuar 2025	Projektuar 2026
ARKËTIMI				
ARKËTIMI I PËRGJITHSHËM	4,617,550	5,012,326	5,160,996	5,313,596
Arketimi nga shërbimet baze të ujit	4,524,066	4,922,326	5,069,996	5,222,096
Arketimi nga shërbimet	93,483	90,000	91,000.00	91,500.00
SHPENZIMET				
Shpenzimet e pagave	2,196,118	2,411,444	2,459,673.10	2,508,866.57
Shpenzimet e energjisë	742,118	700,000	700,000.00	630,000.00
Shpenzimet e karburanteve	33,764	35,000	36,753.53	37,856.13
Shpenzimet e lëvizësve	547,308	480,000	480,000.00	423,000.00
Shpenzimet e kemikaleve	163,342	150,000	150,000.00	135,000.00
Shpenzimet e mirëmbajtjes	54,134	60,000	63,006.05	64,896.23
Shpenzimet e komunikimit	9,604	9,500	9,975.96	10,275.24
Shërbimet e jashtme kontraktuese	178,374	193,720	203,425.53	209,528.30
Te tjera	48,711	49,826	52,322.32	53,891.99
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME	3,973,473	4,089,490	4,155,156	4,073,314
Diferenca Arketim/Shpenzime	644,076	922,836	1,005,839	1,240,281
Investime Kapitale		(922,836)		
Mbyllja Neto		0	1,005,839	1,240,281

Tabela 6. Pasqyra e të ardhurave

	2023	2024
	€	€
Të hyrat		
Te hyrat nga shitja e ujit	4,964,895	5,103,177
Te hyrat nga sherbimet	79,223	76,271
Te hyrat nga subvencionet		
Te hyrat nga donacionet(Te hyrat e shtyra)	1,256,005	1,256,005
Total te Hyrat	6,300,123	6,435,453
Shpenzimet e pagave	2,196,118	2,411,444
Shpenzimet e energjise	742,118	700,000
Shpenzimet e karburanteve	33,764	35,000
Shpenzimet e mirembajtjes	54,134	60,000
Shpenzimet e komunikimit	9,604	9,500
Shërbimet e jashtme kontraktuese	178,374	193,720
Te tjera	48,711	49,826
Borxhet e Fshira	344,748	350,000
Shpenzimet e zhvlerësimit	2,375,182	2,375,182
Total shpenzimet	5,982,754	6,184,672
Fitimi / (humbja) operativ	(393,280)	(379,219)
Shpenzimet financiare		
Të ardhurat financiare		
Fitimi / (humbja) para tatimit	(393,280)	(379,219)
Shpenzimet e tatimit në fitim		
Fitimi / (humbja) i/e vitit	(393,280)	(379,219)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:		
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave	-	-
financiare te operaconeve të huaja, neto nga tatimi		
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit	-	-
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit	(393,280)	(379,219)

3.3 Provizionimi i Llogarive të Arkëtueshme (LL/A)

Provizionimi i llogarive është vlera e cila rezulton gjatë kalkulimit të amortizimit (dëmtimit) të llogarive të arkëtueshme konform kërkesave për metodën e kostos së amortizuar në SNRF 9. Çdo fund vit ndërmarrja duhet të testojë vlerën e zhvlerësimit (dëmtimit) të llogarive të arkëtueshme, nëse rezulton se kemi ngritje të vlerës kjo pjesë njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave, nëse rezulton e kundërta do të njihen si të hyra në pasqyrën e të ardhurave. Vlera totale e provizioneve është një kundër llogari e cila gjatë paraqitjes e redukton vlerën e Llogarive të Arkëtueshme.

Saldo e LL/A të prezantuara në pasqyrat financiare 31 Dhjetor 2022 në vlerë prej 25,871,367 €. Nga këto të Arkëtueshme vetëm nga faturimi i pjesës veriore të Mitrovicës (Mitrovica veriore dhe Zveqani) me 31 dhjetor 2022 kemi të grumbulluar vlerën prej 17,239,356 €.

Vlera totale e LL/A është e grumbulluar ndër vite. Në vitin 2007 është njohur një provizion i LL/A në bazë të raportit nga Kompania rivlerësuese "GRANT THORTON". Nga viti 2007 nuk është njohur më provizionimi i LL/A.

Synojmë që deri në fund të vitit 2023 të bëjmë analiza të mirëfillta në lidhje me aftësinë e inkasimit të arkëtueshmeve nga konsumatorët në mënyrë që provizioni i njohur të përfaqësoj dhe të jetë në përputhje me kërkesat që dalin nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit financiar SNRF 9, duke krijuar politika dhe procedura mbi provizionimin e llogarive të arkëtueshme e cila është në përputhje me kërkesat që dalin nga SNRF 9.

3.4 Menaxhimi i Aseteve

Menaxhimi i asetëve të ujësjellësit paraqet një aspekt jashtëzakonisht të rëndësishëm të kompanisë i cili është duke u zhvilluar dita ditës.

Momentalisht jemi duke punuar në avancimin e këtij sektori dhe personat përgjegjës janë trajnuar për menaxhimin e asetëve dhe deri me tani kemi identifikuar pothuajse pjesën më të madhe të asetëve të cilat janë pronë e ujësjellësit.

Sidoqoftë, aktivitetet tona në këtë drejtim janë intensifikuar dhe po punohet në drejtim të:

- Identifikimit të asetëve/pronave të ujësjellësit të cilat përkundër faktit që në regjistrat kadastral figurojnë në emrin tonë, ato ende janë të uzurpuara apo në shfrytëzim të personave apo subjekteve të ndryshme afariste,
- Inventarizimin e të gjitha asetëve nëntokësore dhe mbitokësore,
- Vlerësimin monetar të asetëve dhe evidentimin e tyre në librat e kontabilitetit etj.

Në realizimin e këtyre objektivave, ne do të ballafaqohemi me sfida të ndryshme si çështja e kthimit të pronave ku kemi paraparë edhe ngritjen e padive ndaj uzurpatorëve të pronave tona.

Në aspektin kohor të realizimit të këtyre objektivave, kemi paraparë që në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 Inicimin e procedurave gjyqësore për rikthimin e pronave në shërbimin tonë në rast të mos reflektimit pozitiv ndaj kërkesave tona për lirim nga uzurpatorët.

Çështje tjetër apo sfidë tjetër do të paraqet edhe vlerësimi i asetëve nëntokësore për të cilat do të kemi nevojë të kërkojmë ekspert dhe ekspertiza nga jashtë kompanisë. Besojmë se çështja duhet të zgjidhet në nivel të KRU-ve të Kosovës.

3.4.1 Plani i menaxhimit të Aseteve

Raporti i PMA-së është ndër dokumentet më të rëndësishme për të cilin është dashur angazhim i të gjitha Departamenteve të KRU-së, andaj me punimin e këtij raporti kemi arritur të kemi të kompletuara të gjitha të dhënat e të gjitha departamenteve të KRU-së në një dokument të vetëm.

Si rezultat i punës në Raportin Plan i Menaxhimit të Aseteve kemi arritur që të kompletojmë shumë të dhëna teknike për Asetet infrastrukturore dhe jo infrastrukturore të cilat kanë munguar. Gjithashtu kemi paraqitur 10 asetet jo infrastrukturore të cilat nuk e kanë gjendjen e operimit të kënaqshëm dhe kanë nevojë për investim të caktuar në bazë të kritikalishtit, shërbyeshmërisë dhe probabilitetit të dështimit të këtyre asetëve duke u bazuar në matricën e përcaktuar nga rregullatori, por kemi edhe shumë punë për të bërë në mënyrë që të kemi një Raport PMA të kompletuar tërësisht. Ky dokument do të na shërbejë neve si KRU "Mitrovica" sh.a., me qëllim të caktimit të prioriteteve tona investive por edhe për çështje të tjera nëse kërkohet nga MZHE ose nga NJMNP. Duhet cekur që lista e investimeve kapitale që buron nga PMA-ja, duhet të bartet edhe në Planin e Biznesit prandaj, raporti i PMA-së është i një rëndësie të veçantë për të pasur planifikim dhe zhvillim të duhur të KRU-së. Gjithashtu ka ndikim edhe në planin e investimeve kapitale në zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe zgjerimin e shërbimeve tek qytetarët nga KRU-së.

Plan i Menaxhimit të Aseteve në vete përmban:

1. Deklaratën e nivelit të shërbimeve
2. Të dhënat për gjendjen ekzistuese e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura
3. Zona e shërbimit dhe numri i konsumatorëve për ujësjellës dhe kanalizim,
4. Të dhënat për Burimet e ujit, Impiantet e përpunimit të ujit, Stacionet e pompimit, Rezervuarët e ujit, Valvulet operuese, kontrolluese të rrjetit të ujësjellësit, Ujëmatësit në prodhim, Ujëmatësit Zonal
5. Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura, pusetat e kanalizimit
6. Top 10 Asetet më kritike
7. Lista e Investimeve kapitale
8. Lista e Planifikimit Financiar
9. Aplikimi i programit të ri EDAMS

3.4.2 EDAMS²

Në vitin 2019 KRU "Mitrovica" Sh.A. zyrtarisht ka pranuar të aplikoj programin për Dizajn-Enxhinieringu dhe Sisteme të Menaxhimit – EDAMS. Programi përfshin tri faza dhe atë:

- Faza e parë – Faza Silver – Menaxhimi i të dhënave të rrjetit (GIS)
- Faza e dytë – Faza Gold – Menaxhimi i Mirëmbajtjes
- Faza e tretë – Faza Platin – Menaxhimi financiar

Faza e Parë - Menaxhimi i të dhënave të rrjetit (GIS)- Faza e parë ka filluar në vitin 2019, dhe ka zgjat për një vit ashtu që të gjitha KRU-të kemi punuar në mbledhjen dhe vendosjen e të dhënave teknike për të gjitha asetet teknike dhe rrjetin primar dhe sekondar dhe pastaj i kemi bartur në sistemin EDAMS. Mirëpo kjo fazë do të vazhdon gjatë tërë kohës së aplikimit të projektit sepse rrjeti dhe asetet teknike është e nevojshme që vazhdimisht të përditësohen. KRU "Mitrovica" Sh.A. në këtë fazë ka arritur të bëjë vendosjen e të gjitha asteve teknike dhe rrjetit primar dhe sekondar në sistemin EDAMS.




Figura 1. Rrjeti i ujit i pasqyruar në programin EDAMS

² EDAMS-është krahu i zhvillimit të softuerit të grupit të kompanive Hydro-Comp dhe qëndron për Engineering Design and Management Systems, Hydro-Comp është një kompani ndërkombëtare e teknologjisë së informacionit dhe konsulencës e specializuar në sistemet e integruara të informacionit të menaxhimit të infrastrukturës së aseteve (të quajtura EDAMS) dhe shërbimet e lidhura me të për shërbimet e shërbimeve, komunave dhe departamenteve qeveritare të mjedisit.




Figura 2. Atributet për rezervuar në programin EDAMS

Faza e dytë – Menaxhimi i Mirëmbajtjes - Faza e dytë ka filluar në momentin kur është konkluduar që faza e parë ka përfunduar, d.m.th. mbledhja e pothuajse të gjitha të dhënave teknike dhe vendosja e tyre në sistemin EDAMS është arritur. Faza e dytë ka për qëllim mbledhjen e informatave rreth aseteve dhe rreth kostos së mirëmbajtjes. Me qëllim që këtë kosto dhe vet vlerën e asetit ti përdorim pastaj në vlerësimin e aseteve dhe krijimin e raporteve duke u dhënë përparësi aseteve, Planit Investiv, Planit të Biznesit dhe planet tjera. Pasi të kemi shënimet e mbledhura dhe të vendosura në sistemin EDAMS, në këtë fazë ne do të jemi në gjendje të përcaktojmë koston e mirëmbajtjes së aseteve kritike gjatë një viti. Andaj nga këto të dhëna ne mund të gjejmë asetet të cilat kanë probabilitet për të dështuar andaj edhe kujdesi ndaj tyre rrjedhimisht do të jetë më i lartë. Me këtë program gjithashtu do jemi në gjendje të kemi raporte shumë më të detajuara se sa në programin e mëparshëm të CRM-së.

KRU "Mitrovica" Sh.A. është në fillim të kësaj faze e cila bazohet në mbledhjen e shënimeve dhe mirëmbajtjen e tyre për asetet të cilat janë evidentuar në fazën e parë.

Faza e tretë – Menaxhimi financiar - Kjo fazë do të vazhdoj pas përfundimit të fazës së dytë dhe si qëllim ka finalizimin, vlerësimin dhe përdorimin e analizave për të menaxhuar me rrjetin në të gjitha fazat financiare.

Objektivat Strategjike te Departamentit Komercial.....

4.1 Leximi

Duke pasur parasysh kushtet e krijuara tek disa konsumatorë, sidomos në apartamente, leximi i ujëmatësve do të bëhet në baza mujore në përjashtim të konsumatorëve të cilët nuk kanë kushte të mira për lexim gjatë sezonit dimëror.

Përveç leximit të ujëmatësve, lexuesi ka për obligim edhe:

- Evidentimin e keqpërdorimeve në teren,
- Lajmërimin e konsumatorëve të rinjë,
- Shpërndarjen e vërejtjeve tek konsumatorët që kanë obligime ndaj KRU "Mitrovica" Sh.A., Lidhjen e kontratave të shërbimeve në mes të KRU Mitrovica Sh.A. dhe Konsumatorëve etj.

4.2 Faturimi

Faturimi i rregullt, i saktë dhe në bazë të konsumit do të sigurohet nga ana e lexuesve të ujëmatësve në vazhdimësi. Faturimi për metër kub për konsumatorë do të pësoj rritje të lehtë duke pasur parasysh ngritjen e numrit të konsumatorëve të rinj. Rritja e numrit të konsumatorëve është paraparë bazuar në objektet e reja në ndërtim e sipër kryesisht në qytet, mirëpo po ashtu kemi paraparë edhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në regjionin e Shalës së Bajgorës.

Ngritja e sasisë së faturuar do të ketë ndikim edhe në ngritjen monetare të faturimit, gjë që do të ndikoj edhe në të hyrat e përgjithshme të kompanisë.

Tabelat në vazhdim paraqesin parashikimet për faturimin e sasisë së ujit në bazë të kategorive dhe njësive për vitin 2024. Një planifikim i tillë është bërë duke u bazuar në trendin e lëvizjes së popullsisë ndër vite, e po ashtu edhe pritjet për lëvizje të lirë të kosovarëve në vende të Bashkimit Evropian (BE).

Tabela 7 Plani i faturimit në m3 Mitrovicë

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	TOTAL
Janar	258,000	26,902	9,577	20,000	900	315,379
Shkurt	256,000	26,555	9,442	20,000	900	312,897
Mars	259,000	27,160	9,666	20,000	900	316,726
Prill	259,000	27,512	9,789	20,000	900	317,201
Maj	261,000	27,923	9,931	20,000	900	319,755
Qershor	265,029	28,434	10,109	20,000	900	324,472

Korrik	274,510	29,455	10,463	20,000	900	335,328
Gusht	274,889	29,496	10,463	20,000	900	335,748
Shtator	265,503	28,485	10,109	20,000	900	324,997
Tetor	261,047	28,005	9,931	20,000	900	319,884
Nëntor	257,231	27,594	9,789	20,000	900	315,514
Dhjetor	265,434	28,478	10,109	20,000	900	324,920
Total	3,156,643	336,000	119,378	240,000	10,800	3,862,822

Tabela 8 Plan i faturimit në m3 - Vushtrri

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	TOTAL
Janar	197,164	14,412	880	24,000	9,500	245,956
Shkurt	194,633	14,226	924	24,000	9,500	243,283
Mars	199,043	14,550	970	24,000	9,500	248,063
Prill	201,612	14,739	1,019	24,000	9,500	250,869
Maj	204,608	14,959	1,070	24,000	9,500	254,137
Qershor	208,331	15,232	1,123	24,000	9,500	258,186
Korrik	215,775	15,779	1,179	24,000	9,500	266,234
Gusht	216,073	15,801	1,238	24,000	9,500	266,612
Shtator	208,703	15,260	1,300	24,000	9,500	258,763
Tetor	205,204	15,003	1,365	24,000	9,500	255,072
Nëntor	202,207	14,783	1,433	24,000	9,500	251,923
Dhjetor	208,648	15,256	1,505	24,000	9,500	258,909
Total	2,462,000	180,000	14,007	288,000	114,000	3,058,007

Tabela 9 Plan i faturimit në m3 – Skenderaj

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	TOTAL
Janar	65,000	9,208	480	6,726	-	81,414
Shkurt	62,000	9,089	474	6,639	-	78,202
Mars	67,000	9,296	485	6,790	-	83,571
Prill	74,000	9,416	491	6,878	-	90,786
Maj	75,000	9,557	499	6,981	-	92,037
Qershor	78,000	9,732	508	7,108	-	95,348
Korrik	82,000	10,081	526	7,364	-	99,971
Gusht	82,000	10,095	527	7,374	-	99,996
Shtator	76,000	9,749	509	7,121	-	93,379
Tetor	74,000	9,585	500	7,001	-	91,086
Nëntor	72,000	9,444	493	6,899	-	88,836
Dhjetor	75,000	9,747	509	7,119	-	92,375
Total	882,000	115,000	6,000	84,000	-	1,087,000

Tabela 10 Plani i faturimit në m3 – Veriu | Mitrovicës dhe Zveçani

Kategoria	Faturimi nga uji me shumicë (€)
Janar	400,000
Shkurt	400,000
Mars	400,000
Prill	400,000
Maj	400,000
Qershor	400,000
Korrik	400,000
Gusht	400,000
Shtator	400,000
Tetor	400,000
Nëntor	400,000
Dhjetor	400,000
Total	4,800,000

Tabela 11 Rekapitullimi i faturimit në m3 – KRU " Mitrovica " Sh.A.

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	Veriu dhe Zveçani	TOTAL
Janar	520,164	50,522	10,937	50,726	10,400	400,000	1,042,749
Shkurt	512,633	49,870	10,840	50,639	10,400	400,000	1,034,382
Mars	525,043	51,006	11,121	50,790	10,400	400,000	1,048,360
Prill	534,612	51,668	11,299	50,878	10,400	400,000	1,058,856
Maj	540,608	52,440	11,500	50,981	10,400	400,000	1,065,928
Qershor	551,360	53,398	11,740	51,108	10,400	400,000	1,078,006
Korrik	572,285	55,316	12,169	51,364	10,400	400,000	1,101,533
Gusht	572,962	55,392	12,228	51,374	10,400	400,000	1,102,356
Shtator	550,206	53,494	11,918	51,121	10,400	400,000	1,077,139
Tetor	540,251	52,593	11,797	51,001	10,400	400,000	1,066,042
Nëntor	531,438	51,821	11,715	50,899	10,400	400,000	1,056,273
Dhjetor	549,082	53,480	12,122	51,119	10,400	400,000	1,076,204
Total	6,500,643	631,000	139,386	612,000	124,800	4,800,000	12,807,829

Tabela 12 Plani i faturimit në Euro – Mitrovicë

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	TOTAL
Janar	139,552	23,819	8,479	13,386	526	185,761
Shkurt	138,470	23,511	8,360	13,386	526	184,252
Mars	140,093	24,047	8,558	13,386	526	186,609
Prill	140,093	24,359	8,667	13,386	526	187,029
Maj	141,175	24,722	8,793	13,386	526	188,602

Qershor	143,354	25,174	8,950	13,386	526	191,390
Korrik	148,482	26,078	9,264	13,386	526	197,736
Gusht	148,687	26,114	9,264	13,386	526	197,977
Shtator	143,611	25,220	8,950	13,386	526	191,692
Tetor	141,201	24,795	8,793	13,386	526	188,700
Nëntor	139,136	24,431	8,667	13,386	526	186,145
Dhjetor	143,573	25,213	8,950	13,386	526	191,648
Total	1,707,428	297,483	105,694	150,627	6,308	2,277,540

Tabela 13 Plani i faturimit në Euro - Vushtri

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	TOTAL
Janar	106,646	12,760	779	10,500	5,132	135,817
Shkurt	105,277	12,595	818	10,500	5,132	134,322
Mars	107,662	12,882	859	10,500	5,132	137,035
Prill	109,052	13,049	902	10,500	5,132	138,635
Maj	110,673	13,244	947	10,500	5,132	140,496
Qershor	112,686	13,486	994	10,500	5,132	142,799
Korrik	116,713	13,971	1,044	10,500	5,132	147,359
Gusht	116,874	13,990	1,096	10,500	5,132	147,592
Shtator	112,887	13,510	1,151	10,500	5,132	143,181
Tetor	110,995	13,283	1,209	10,500	5,132	141,118
Nëntor	109,374	13,088	1,269	10,500	5,132	139,363
Dhjetor	112,858	13,507	1,333	10,500	5,132	143,330
Total	1,331,696	159,366	12,401	126,000	61,585	1,691,048

Tabela 14 Plani i faturimit në Euro – Skenderaj

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	TOTAL
Janar	35,159	8,152	425	5,994		49,730
Shkurt	33,536	8,047	420	5,994		47,997
Mars	36,240	8,230	429	5,994		50,894
Prill	40,027	8,337	435	5,994		54,793
Maj	40,568	8,462	441	5,994		55,465
Qershor	42,190	8,616	450	5,994		57,250
Korrik	44,354	8,926	466	5,994		59,739
Gusht	44,354	8,938	466	5,994		59,752
Shtator	41,108	8,632	450	5,994		56,184
Tetor	40,027	8,486	443	5,994		54,950
Nëntor	38,945	8,362	436	5,994		53,737
Dhjetor	40,568	8,629	450	5,994		55,641
Total	477,074	101,817	5,312	71,978	-	656,131

Tabela 15 Plani I faturimit në Euro – Veriu i Mitrovicës dhe Zveçan

Kategoria	Faturimi nga uji me shumicë (€)
Janar	73,440
Shkurt	73,440
Mars	73,440
Prill	73,440
Maj	73,440
Qershor	73,440
Korrik	73,440
Gusht	73,440
Shtator	73,440
Tetor	73,440
Nëntor	73,440
Dhjetor	73,440
Total	881,280

Tabela 16 Rekapitullimi – Plani I Faturimit për 2024 KRU " Mitrovica " Sh.A.

Kategoria	Amviseri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	Veriu dhe Zveçani	TOTAL
Janar	281,357	44,731	9,683	29,880	5,658	73,440	444,748
Shkurt	277,283	44,153	9,598	29,880	5,658	73,440	440,011
Mars	283,996	45,159	9,847	29,880	5,658	73,440	447,979
Prill	289,171	45,745	10,003	29,880	5,658	73,440	453,897
Maj	292,415	46,428	10,181	29,880	5,658	73,440	458,002
Qershor	298,231	47,277	10,394	29,880	5,658	73,440	464,879
Korrik	309,549	48,974	10,774	29,880	5,658	73,440	478,274
Gusht	309,915	49,042	10,827	29,880	5,658	73,440	478,761
Shtator	297,606	47,362	10,551	29,880	5,658	73,440	464,497
Tetor	292,222	46,564	10,444	29,880	5,658	73,440	458,208
Nëntor	287,455	45,881	10,372	29,880	5,658	73,440	452,685
Dhjetor	296,999	47,349	10,733	29,880	5,658	73,440	464,058
Total	3,516,198	558,666	123,407	358,555	67,894	881,280	5,505,999

4.3 Inkasimi

KRU Mitrovica Sh.A. në vazhdimësi do të ofroj kushte dhe mundësi për konsumatorët e vetë duke iu ofruar mundësinë e pagesave nëpërmes institucioneve mikro financiare, bankave dhe përmes zhvillimit të modulit e-KRUM (përmes së cilës platformë konsumatori do ketë qasje në llogarinë/kartelën e tij/saj 24/7 dhe do të kenë mundësinë e pagesës së obligimeve ndaj KRUM-së), ofrimin e pikave të pagesave më afër

konsumatorëve etj.

Për vitin 2024 për të arritur objektivat e KRU Mitrovica Sh.A. do të vepohet si në vijim:

- Organizimin e takimeve me grupe të ndryshme të qytetarëve për t'i informuar sa më mirë në lidhje me të gjitha çështjet që lidhen me brengat e tyre,
- Shpërndarja e fletushkave, broshurave informuese mbi faturimin, çmimin, përlllogaritjen e faturës etj.
- Informimin e vazhdueshëm për mundësitë e lidhjes së kontratave mbi ri programimin e borxheve të vjetra,
- Insistimin dhe sqarimin në lidhje me obligimet e konsumatorëve ndaj nesh dhe obligimet tona ndaj konsumatorëve,
- Në raste të caktuara edhe iniciimin e procedurës përmbartimore.

Tabela 17 Plani i Inkasimit për 2024 – Mitrovicë

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	TOTAL
Janar	152,551	23,819	8,479	13,386	526	198,759
Shkurt	151,562	23,511	8,360	13,386	526	197,344
Mars	153,045	24,047	8,558	13,386	526	199,561
Prill	153,045	24,359	8,667	13,386	526	199,981
Maj	154,034	24,722	8,793	13,386	526	201,461
Qershor	156,026	25,174	8,950	13,386	526	204,061
Korrik	160,713	26,078	9,264	13,386	526	209,966
Gusht	160,900	26,114	9,264	13,386	526	210,190
Shtator	156,260	25,220	8,950	13,386	526	204,341
Tetor	154,057	24,795	8,793	13,386	526	201,556
Nëntor	152,171	24,431	8,667	13,386	526	199,179
Dhjetor	156,226	25,213	8,950	13,386	526	204,300
Total	1,860,589	297,483	105,694	160,627	6,308	2,430,701

Tabela 18 Plani i Inkasimit për 2024 – Vushtrri

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	TOTAL
Janar	114,974	12,760	779	10,500	5,132	144,145
Shkurt	113,723	12,595	818	10,500	5,132	142,768
Mars	115,903	12,882	859	10,500	5,132	145,276
Prill	117,173	13,049	902	10,500	5,132	146,756
Maj	118,655	13,244	947	10,500	5,132	148,478
Qershor	120,495	13,486	994	10,500	5,132	150,608
Korrik	124,175	13,971	1,044	10,500	5,132	154,822
Gusht	124,323	13,990	1,096	10,500	5,132	155,041
Shtator	120,679	13,510	1,151	10,500	5,132	150,973
Tetor	118,949	13,283	1,209	10,500	5,132	149,073

Nëntor	117,468	13,088	1,269	10,500	5,132	147,457
Dhjetor	120,652	13,507	1,333	10,500	5,132	151,124
Total	1,427,170	159,366	12,401	126,000	61,585	1,786,522

Tabela 19 Plani i Inkasimit për 2024 – Skenderaj

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	TOTAL
Janar	39,635	8,152	429	5,994	-	54,206
Shkurt	38,152	8,047	420	5,994	-	52,613
Mars	40,624	8,230	429	5,994	-	55,277
Prill	44,084	8,337	435	5,994	-	58,850
Maj	44,579	8,462	441	5,994	-	59,476
Qershor	46,062	8,616	450	5,994	-	61,122
Korrik	48,039	8,926	466	5,994	-	63,425
Gusht	48,039	8,938	466	5,994	-	63,438
Shtator	45,073	8,632	450	5,994	-	60,149
Tetor	44,084	8,486	443	5,994	-	59,007
Nëntor	43,096	8,362	436	5,994	-	57,888
Dhjetor	44,579	8,629	450	5,994	-	59,652
Total	526,045	101,817	5,312	71,928	-	705,103

Tabela 20 Plani i Inkasimit për 2024 – KRU "Mitrovica" Sh.A.

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombëtar	TOTAL
Janar	307,160	44,731	9,683	29,880	5,658	397,111
Shkurt	303,437	44,153	9,598	29,880	5,658	392,725
Mars	309,572	45,159	9,847	29,880	5,658	400,115
Prill	314,303	45,745	10,003	29,880	5,658	405,588
Maj	317,267	46,428	10,181	29,880	5,658	409,414
Qershor	322,583	47,277	10,394	29,880	5,658	415,791
Korrik	332,928	48,974	10,774	29,880	5,658	428,213
Gusht	333,262	49,042	10,827	29,880	5,658	428,669
Shtator	322,012	47,362	10,551	29,880	5,658	415,463
Tetor	317,091	46,564	10,444	29,880	5,658	409,637
Nëntor	312,734	45,881	10,372	29,880	5,658	404,524
Dhjetor	321,457	47,349	10,733	29,880	5,658	415,076
Total	3,813,805	558,666	123,407	358,555	67,894	4,922,326

4.4 Plani për rritjen e numrit të konsumatorëve

Në vitin 2024 parashihet që numri i konsumatorëve të arrijë në 50,100 konsumatorë pasi që do të ketë shtrirje të rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale në një rën anë dhe identifikimi i konsumatorëve të jashtëligjshëm/illegal dhe objekte të reja kolektive.

Ndërsa, në fund të vitit 2025 parashihet rritja e numrit të konsumatorëve në përgjithësi, me theks të veçantë në amvisëri, e thënë kjo për faktin se konsumatorët e ri të cilët do të kyçen në rrjetin e ujësjellësit vijnë nga pjesët rurale dhe objektet kolektive të cilët (në përgjithësi) i përkasin kategorisë së amvisërisë.

Në bazë të parashikimeve pritet që në vitin 2024 numri i konsumatorëve të arrijë në 50,100, kurse në vitin 2025 në 51,000 si dhe në vitin 2026 numri i konsumatorëve parashihet që të arrijë në 51,950. Tabela në vazhdim pasqyron të dhënat e parashikuara për numrin rritjen e konsumatorëve për periudhën planifikuese 2024 -2026 bazuar në të dhënat e viteve paraprake dhe trendi real i zhvillimit.

Ne çka bazohet kjo a ka ndonjë referencë

Tabela 21 Numri i planifikuar i konsumatorëve sipas viteve

Numri i konsumatorëve	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
KRUJM	50,100	51,000	51,950

4.5 Menaxhimi i kërkesave/ankesave të konsumatorëve

Menaxhimi i ankesave/kërkesave do të vazhdojë të funksionojë në bazë të softuerit CRM dhe komisionit për shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave/kërkesave të konsumatorëve duke u bazuar dhe respektuar rregulloret e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Në kuadër të softuerit CRM, parashihet që të funksionalizohet edhe pjesa komerciale dhe teknike si dhe modulet e tjera të cilat janë pjesë përbërëse e këtij moduli. Këtij procesi do ti shtohet edhe pjesa fizike (kopje e fortë) e cila do të skanohet dhe do të krijohet dosja elektronike e konsumatorit (për kërkesa/ankesa). Duke pasur parasysh se jemi duke punuar në funksionalizimin dhe zgjerimin e shumë proceseve të brendshme të kompanisë, parashihet që të rekrutojmë staf shtesë që do të ndihmojnë në arritjen e synimeve tona .

4.6 Plani për menaxhimin e leximit të ujëmatësve

Leximi dhe faturimi i konsumatorëve do të bëhet në vazhdimësi në bazë mujore. Përveç pajisjeve ekzistuese (PDA), në përdorim kemi edhe telefonat mobil të cilët posedojnë edhe shtypësit mobil të faturave. Në vitet në

vazhdim do të sigurojmë më tepër telefona mobil në mënyrë që secili lexues të operoj me telefon, pasi që kjo mënyrë është më efikase dhe e shpejtë.

Veç kësaj edhe konsumatorët do të jenë më të kënaqur me shërbimet e ofruara nga kompania, prandaj me këtë rritet edhe besueshmëria e konsumatorit ndaj ujësjellësit.

Sektori komercial do të ofroj informata shtesë për sektorin teknik lidhur me; ujëmatësit të cilët nuk mund të lexohen (shihen), të prishur, të demontuar/larguar nga konsumatori si dhe ujëmatësit e manipuluar nga konsumatorët si mbështetje për aktivitetet e teknikës në terren.

Në vitin 2024 parashihet që të rrisim numrin e lexuesve të ujëmatësve pasi që momentalisht një pjesë e lexuesve kanë mbi 1000 konsumatorë. Kjo do të mundësoj rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të lexuesve në terren; leximi i saktë dhe i rregullt, përditësimi i rregullt i të dhënave të konsumatorëve, përtëritja e kontratave të vjetra dhe lidhja e kontratave të reja të shërbimit.

2023	2024	2025	2026

... (faint text) ...

... (faint text) ...

5 SHËRBIMI TEKNIK

5.1 Hyrje

Objektivat strategjike të Departamentit Teknik për vitet në vazhdim :

5.1.1 Humbjet e ujit,

Zvogëlimi i humbjeve të ujit (UPF) paraqet padyshim një prej sfidave më të mëdha për faktin se aktualisht më tepër se gjysma e ujit të trajtuar të cilin Kompania e distribuon në sistem (55% vit) nuk faturohet si pasojë qoftë e humbjeve fizike (rrjedhjet nga gypat) apo humbjeve komerciale (gabimet në matje dhe lexim, vjedhjet etj.). Shkalla kaq e lartë e humbjeve të ujit jo vetëm që shkakton humbje substanciale financiare për Kompaninë por ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e furnizimit të konsumatorëve (ndërprerjet e rregullta në furnizim) që ka për pasojë rrezikimin e cilësisë së ujit dhe rrjedhimisht paraqet kërcënim permanent për shëndetin e popullatës.

Për arritjen e caqeve të përcaktuara, Kompania do të përqendrojë aktivitetet e veta në katër shtylla kryesore:

- (i) Detektimi dhe riparimi sistematik i të gjitha rrjedhjeve si dhe monitorimi i rrjetit distributiv në kuadër të sektorëve të përcaktuar (Zonat e Matura-DMA).
- (ii) Në kordinim me Departamentin komercial ne Eliminimin e parregullsive të lidhura me faturimin e saktë në bazë të konsumit real të konsumatorëve;
- (iii) Identifikimi dhe legalizimi/shkycja e të gjitha kyçjeve të paligjshme;

5.1.2 Kualiteti i shërbimit dhe cilësia e ujit,

Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve tona ndaj konsumatorit është objektiv i vazhdueshëm në të cilin punojmë pa ndërprerë me qëllim të përmirësimit të kënaqëshmërisë së konsumatorëve me shërbimet tona.

Nga ana tjetër, sigurimi i ujit të pijshëm tani dhe në të ardhmen është objektiv kryesor dhe pjesë integrale e vizionit tonë. Shëndeti i popullatës sonë është mbi të gjitha prandaj ofrimi i ujit cilësor është pjesë përbërëse e shëndetit të përgjithshëm.

Monitorimi i përgjithshëm i procesit të trajtimit dhe cilësia e ujit të trajtuar në Impiantet për Trajtimin e Ujit (ITU), monitorohet në baza të rregullta përmes:

- Sistemi SCADA – online 24h,
- Analizave fiziko - kimike
- Institutit Kombëtarë të Shëndetit Publik (IKSHP) – analizat bakteriologjike

Pajisja dhe zëvendësimi i ujëmatësve,

Kompania Rajonale Ujësjellësi “Mitrovica”, për periudhën planifikuese 2024 - 2026 do të siguron shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit në regjionin e Mitrovicës: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Mitrovicë Veriore,

Zvečan. KRU Mitrovica" Sh.A. mirëmbajtjen e rrjetit të ujit dhe të kanalizimit e bënë edhe në pjesën veriore dhe Zvečan sipas kërkesave të njësisë së Veriut. Duke u bazuar në të dhënat e Agjencionit Statistikore të Kosovës për popullsinë, menaxhmenti i Kompanisë vlerëson se deri në 2026 në regjion, pritet një rritje e numrit të ekonomive familjare (konsumatorëve shtëpiak). Kjo rritje e numrit të ekonomive familjare do të ndikojë në rritjen e kërkesës për ujë të pijshëm, gjë që kompania mund ta përballojë me kapacitetet e tanishme të Impianteve të Trajtimit të Ujit në Shipol dhe Ballnc. Duke u bazuar në të dhënat e iartpërmendura parashikohet se deri në fund të vitit 2026 përqindja e mbulimit me shërbime të furnizimit me rrjet të ujës-jellësit dhe kanalizimit do të jetë :

- Me furnizim me ujë , mbi 95 % e regjionit të Mitrovicës,
- Me rrjet të kanalizimit mbi 85 % dhe
- Trajtimi i ujërave të ndotura do të rritet deri 65 %, marrë për bazë planifikimin e ndërtimit të Impiantit të ri për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) dhe kolektorëve kryesor dhe rrjetit sekondar të ujërave të ndotura që do të ndërtohet në Komunën e Mitrovicës dhe Vushtrrisë.

5.2 Mirëmbajtja e automjeteve (autoparku)

Makineria aktuale e KRU "Mitrovica" Sh.A. vlerësohet si makineri e mangët në numër në njërin anë dhe e vjetruar në anën tjetër. Duke pas parasysh se në dy vitet e fundit ka një rritje të numrit të konsumatorëve, zgjerim të rrjetit të ujit të pijes dhe kanalizimit, si dhe synimet që i kemi për tri vitet e ardhshme, si rezultat i kësaj lind nevoja për investim në mjete transportuese për mirëmbajtjen e rrjetit të ujit, kanalizimit , mirëmbajtjen e ITU-ve, stacioneve të pompimit dhe leximin e faturave.

5.3 Zbulimi i rrjedhjeve

Një ndër problemet madhore me të cilin po ballafaqohemi gjatë afarizmit tonë, janë rrjedhjet nëntokësore të ujit të cilat për shkak të konfiguracionit të tokës dhe prezencës së lumenjve në afërsi të tubacionit të ujës-jellësit, është e vështirë të zbulohen pasi që rrjedhjet nuk shfaqen në sipërfaqe, për shkak se uji depërton në shtresën ranore të tokës dhe përfundon në lumë. Kjo dukuri është e evidente sidomos në Mitrovicë ku kemi katër lumenj, por edhe në Vushtrri dhe Skenderaj por në masë më të vogël.

Me qëllim të realizimit të këtij objekti të rëndësishëm, gjatë vitit 2024 do të intensifikojmë kërkimet në zbulimin e rrjedhjeve sidomos gjatë orëve të natës kur nëpër lokacione të ndryshme nuk ka zhurmë, konsumi i ujit është shumë i ulët, ndërsa presioni i ujit në tubacion i lartë gjë që e bënë më të lehtë zbulimin e rrjedhjeve nëntokësore, përmes pajisjeve zbuluese akustike. Ky aktivitet do të kryhet përmes caktimit të zonave tek të cilat dyshohet se ka shpenzim të lartë të ujit të pijes.

Aktivitetet në detektimin e rrjedhjeve do të zhvillohen gjatë gjithë vitit, por vëmendja kryesore do të ndodhë gjatë muajve Prill – Shtator pasi që intervenimet në rrjetë janë më të lehta për t'u sanuar.

5.4 Prodhimi & Operimi në Impiante

Impiantet për trajtimin e ujit në Shipol të Mitrovicës dhe Balinc të Vushtrrisë parashihet që të vazhdojnë operimin e tyre me kapacitetet prodhuese normale. Impiantet e trajtimit të ujit, të gjithë qytetarëve të vet u garantojnë ujë cilësor, gjë e cila vërtetohet në bazë të analizave që kryhen në ITU-të në Shipol dhe Balinc si dhe nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP). Disa nga aktivitetet e njësive operative që kemi planifikuar të i ndërmarrim kanë të bëjnë me; vazhdimësinë e eliminimit të rrjedhjeve të evidentuara, zëvendësimin e ujëmatësve të dëmtuar, eliminimin e vjedhjeve, keqpërdorimeve të ujit të pijes e të cilat do të ndikojnë në zvogëlimin e sasisë së ujit të prodhuar nga njëra anë dhe zvogëlimin e humbjeve, respektivisht ujin e pa faturuar.

Tabela 22 Kapacitetet prodhuese të ITU-ve

Impiantet për trajtimin e ujit (ITU)	2024		2025		2026	
	Maksimal	Përdorur	Maksimal	Përdorur	Maksimal	Përdorur
ITU në Shipol	700 l/s	610 l/s	700 l/s	610 l/s	700 l/s	610 l/s
ITU në Vushtri	300 l/s	230 l/s	300 l/s	230 l/s	300 l/s	230 l/s
Total	1,000 l/s	840 l/s	1,000 l/s	840 l/s	1,000 l/s	840 l/s

5.5 Mirëmbajtja e elektro makinerisë

Sektori i mirëmbajtjes së elektro makinerisë është sektor, i cili mbikëqyrë dhe mirëmban pajisjet e elektro – makinerisë në të gjitha ITU-të dhe stacionet e pompave në nivel regionit, në mënyrë që të sigurohet furnizimi 24 orë për konsumatorët tanë. Duke pasur parasysh se disa stacione të pompave janë të vjetruara kemi paraparë që brenda periudhës tri vjeçare të investohet në ndërrimin e pompave dhe motorëve në mënyrë që të sigurohen pompa dhe motor efikas të cilët do të na mundësojnë kursimin e energjisë elektrike. Departamenti Teknik planifikon që brenda tri viteve 2024-2026 të digjitalizohen të gjitha stacionet e pompimit duke rritur kështu efikasitetin në punë.

5.6 Grumbullimi dhe trajtimi i Ujërave të Ndotura

Ujërat e ndotura të qytetit të Mitrovicës, Vushtrrisë, Zveçanit dhe Zubin Potokut ende nuk trajtohen dhe vazhdojnë të derdhen në disa pika të lumit Ibër, Sitnica, Tërrstena, Lushte dhe lumi Trepça që rrjedh nga Tuneli i Parë deri në hyrje të qytetit të Mitrovicës. Kjo situatë do të vazhdoj deri në ndërtimin e Impiantit për

Trajtimin e Ujërave të ndotura, i cili pritet të përfundon së bashku me kolektorët kryesor deri në fund të vitit 2027.

Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura momentalisht bëhet vetëm për komunën e Skenderajt, kryesisht të pjesëve urbane të cilat janë të kyçura në impiantin e Llaushës dhe një pjesë tjetër e trajtimit biologjik sipërfaqësor në fshatin Tërrnafc i cili trajtim njihet si trajtim i hapur me kallmishta do të vazhdojë edhe viteve në vijim 2024-2026.

5.7 Instalimi i ujëmatësve

Faturimi i konsumatorëve në bazë të konsumit real është prioritet i yni, prandaj instalimi i ujëmatësve dhe largimi i faturimit në bazë paushallë (pa matje), dhe me këtë arrihet mbulimi i plotë konsumatorëve me ujëmatës. Kompania ka paraparë që në vitin 2024 të siguroj ujëmatës me qëllim zëvendësimin periodik sikurse parashihet me rregullore. Kjo do të na mundësoj që të orientohemi më shumë në gjurmimin dhe zbulimin e kyçjeve ilegale dhe të tërthorta. Realizimi i këtij plani do të bëhet nga Departamenti Teknik sipas dinamikës mujore ku parashihet që për çdo muaj të instalohen rreth 200 ujëmatës. Ky projekt është paraparë që të bëhen përmes tenderit publik i cili do të kushtoj 150,000€ dhe i cili është prezantuar në tabelën e projekteve për vitin 2024.

Me qëllim të zvogëlimit të humbjeve teknike dhe komerciale, kemi paraparë sigurimin dhe montimin e ujëmatësve zonal si dhe kontrollimin dhe riparimin e pusetave ekzistuese në të cilat shpesh ka rrjedhje dhe riparimi i tyre do të ketë efekt pozitiv në reduktimin e humbjeve dhe ujit të pa faturuar.

6.1 Qëllimi dhe Objektivat Strategjike

Strategjia përbën një pjesë integrale të zbatimit, respektivisht implementimit të aktiviteteve tona e cila do të siguroj infrastrukturë të qëndrueshme të shërbimeve e cila strategji do të jetë gjithëpërfshirëse dhe e orientuar tek konsumatori.

Angazhimi, përfshirja dhe konsultimi i konsumatorëve dhe palëve të ndryshme të interesit do të përqendrohet në ofrimin e mundësisë së pjesëmarrjes së tyre përmes informimit, konsultimit, bashkëpunimit, përfshirjes dhe fuqizimit e cila qasje do të shërbej edhe si nxitëse për ne që të zbatojmë planet/strategjitë afatgjatë.

Prandaj, kjo strategji do të shërbej si udhërrëfyes i cili përcakton drejtimin, objektivat dhe fushëveprimin e përgjithshëm të rrugëtimit tonë në drejtim të realizimit të vizionit dhe misionit tonë.

Qëllimi përfundimtarë i kësaj strategjie është që duke avancuar programet/kanalet e komunikimit me publikun në përgjithësi dhe konsumatorin në veçanti përmes sigurimit të aktiviteteve të ndërgjegjësimit, vetëdijësimit dhe informimit do të ndikoj në ngritjen e përgjithshme të imazhit të kompanisë.

6.2 Marrëdhëniet me Publikun (PR)

Në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të mira me publikun, KRU "Mitrovica" Sh.A. është e përkushtuar që të vazhdoj informimin, bashkëpunimin dhe bashkëveprimin përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit nëpërmjet organizimit të:

- Bashkëbisedimit të drejtpërdrejtë me publikun përmes organizimit të takimeve me grupe të ndryshme të interesit: fëmijët, nxënësit e shkollave, përfaqësuesit e lagjeve, fshatrave etj.
- Organizimit të fushatave të ndërgjegjësimit në lidhje me rolin dhe rëndësinë e kursimit të ujit të pijes, përdorimin racional të ujit, rëndësinë e ujit të pijes në jetën e njeriut etj.
- Intervistave në radio dhe televizion,
- Organizimi i datave të rëndësishme si: "Dita Botërore e Ujit" me ç 'rast do të organizohen ligjërata e vizita në Impiantet për Trajtimin e Ujit të Pijes dhe Ujërave të Ndotura.

6.3 Komunikimi

Komunikimi si mjet i domosdoshëm për punën e përditshme ndihmon kompaninë në arritjen e objektivave të saj, prandaj komunikimi si proces me konsumatorë, do të përfshijë palët e ndryshme të interesit dhe publikun e gjerë do të ndihmoj po ashtu edhe sigurimin e vetë qëndrueshmërisë së shërbimeve tona.

Ky proces ka për qëllim që konsumatorit ti komunikoj informata në lidhje me:

- Qasjen ndaj ujit të pijes; shfrytëzimi racional i ujit, kursimi, pagesa e rregullt, mirëmbajtja etj.
- Mbrojtjen e burimeve ujore: mbajtja e pastërtisë me theks të veçantë në afërsi të burimeve, mos ndotja e ambientit etj.
- Sëmundjet hidrike; vetëdijësimi mbi rrezikun e shëndetit si pasojë e ujit të pijes i cili mund të vij si pasojë e ndotjeve të ambientit,
- Planet afatgjatë të zhvillimit; informimi i qytetarëve mbi planet zhvillimore në të ardhmen,
- Të drejtat dhe obligimet e konsumatorëve; publikimi i kartës së konsumatorëve,
- Legjislacioni; ligjet, rregulloret, udhëzimet administrative etj.

6.4 Vetëdijësimi/Ndërgjegjësimi

Organizimi i fushatave të cilat kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes qytetare dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve në lidhje me përdorimin racional të ujit të pijes, kursimin e ujit të pijes gjatë muajve të verës kur kemi konsum enorm të ujit, cilësinë e ujit të pijes dhe rëndësinë e ujit për shëndetin e popullatës, pagesën e faturave për shërbime të ujësjellësit etj., do të organizohen në vazhdimësi si në pjesët rurale ashtu edhe në ato urbane në bazë të planit të paraparë të veprimit.

6.5 Marketingu

Marketingu si pjesë e rëndësishme e promovimit të punës, vlerave dhe shërbimeve të KRU "Mitrovica" Sh.A. ka munguar në planet strategjike në të kaluarën për faktin se gjendja financiare e kompanisë nuk e ka mundësuar një gjë të tillë. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e promovimit përmes marketingut dhe ndikimin e tyre në imazhin dhe performancën e kompanisë kemi planifikuar që në vitin 2024 e tutje, marketingut t'i kushtohet kujdes i veçantë.

Një ndër aktivitetet të cilin kemi planifikuar ta zhvillojmë si pjesë e shënimit të "Ditës Botërore të Ujit" e cila shënohet me 22 mars, do të jetë organizimi i një kuisi apo gare në mënyrë rast do të vlerësoheshin njohurit mbi ujin. Me atë rast parashihet të ndahen çmime simbolike për tri vendet e para.

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve nëpër shkolla dhe institucione arsimore, planifikojmë të sigurojmë dhurata të ndryshme të cilat do të u shpërndahen nxënësve/pjesëmarrësve si: maicë, fletushka, broshura, lapsa dhe dhurata tjera të cilat do të mbajnë logon e ujësjellësit".

Tabela 23. Strategjia e PR & Marketingut

Nr. rendor	Aktiviteti	Nga kush	Kur
1	Aktivitate Informuese	Zyra për PR & Marketing	Gjatë gjithë vitit
2	Shënimi i Ditës Botërore të Ujit	Zyra për PR & Marketing	Mars 2024
3	Ligjorato në institucionet arsimore në tërë regjionin	Zyra për PR & Marketing	Mars 2024
4	Bashkëbisedim me grupe të ndryshme të interesit: përfaqësues të fshatrave, institucioneve etj.	Zyra për PR & Marketing	Prill 2024
5	Vizita me karakter edukativo-informativ ITN & ITUN	Zyra për PR & Marketing dhe ITU-të	Prill – Maj 2024
6	Aksion: "T'a mbajmë të pastër ambientin ku jetojmë"	Zyra për PR & Marketing, KRUM	Maj apo Qershor 2024
7	Eushata vetëdijesuese mbi rolin e ujit të pijes, kursimit dhe përdorimit racional etj.	Zyra për PR & Marketing, Komerciale	Qershor – Korrik 2024
8	Realizimi i dokumentarit dhe publikimi	Zyra për PR & Marketing, Teknika, Komerciale, Financa etj.	Gusht 2024
9	Debat Publik me ARRU dhe palët tjera të interesit	PR & Marketing	Nëntor 2024
10	Prezantimi & Koktej rast për fund vit	PR & Marketing	Dhjetor 2024

Si pjesë e marketingut është paraparë edhe përgatitja e një dokumentari të shkurtër televiziv për çka do të angazhojmë një stacion televiziv. Ky dokumentar do të paraqes në mënyrë vizuale të gjitha aspektet e ujësjellësit, duke filluar nga kaptimi i ujit në Lushtë gjer tek uji i cili rrjedh nga rubineti, të shoqëruara me të dhënat mbi arritjet, mundësitë, sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohemi por edhe prezantimin e planeve zhvillimore në të ardhmen.

Po ashtu është paraparë zhvillimi i aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me pastrimin e ambientit ku jetojmë.

Aktivitetet e planifikuara për vitin 2024 dhe buxhetin e parashikuar për vitet 2025 dhe 2026 e kemi paraqitur në tabelën në vazhdim.

Tabela 24. Aktivitetet dhe buxheti për Informim Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing

	2024			2025	2026
	Sasia	Çmimi	Gjithsej €	Gjithsej €	Gjithsej €
A - AKTIVITET AVOKUESE					
Takime / mbledhje me grupe të ndryshme të interesit: institucione, përfaqësues të komunitetit etj.	3	200	600	700	800

Tryezat e rrumbullakëta, debate publike	2	150	300	400	500
Kampanja sensibilizuese (në kombinim me institucionet qeveritare dhe jo qeveritare)	3	100	300	300	300
Total A			1,200	1,400	1,600
B - AKTIVITETET PROPAGANDESE TË EDUKIMIT DHE VETËDUESIMIT					
Seminare – shfrytëzimi racional i ujit dhe pagesa ndaj shërbimeve	6	100	600	700	800
Seminare – roli i ujit të pijes në shëndetin e njeriut	6	100	600	700	800
Seminare – mbrojtjen e ambientit dhe burimet ujore	6	100	600	700	800
Seminare – tjera (që dalin nga KRU-të)	2	100	200	300	400
Vizita me karakter të ndërgjegjësimit në ITU	6	150	900	900	900
Aktivitete tjera			100	100	100
Total B			3,000	3,400	3,800
C - PLANIFIKIMI DHE PËRGATITJA E FUSHATAVE					
Dizajni i materialeve propaganduese		300	300	350	400
Përgatitja e materialeve:(poster, broshura, lapsa, kalendarë etj)			1,000	1,100	1,000
Maica për kampanjë	300	4	1,200	1,300	1,200
Filmi dokumentar për KRU "Mitrovica" Sh.A.	1	2500	2,500	0	0
Seminare sensibilizuese:(Çështjet e ndryshme, rastet sociale, roli i grave, OJQ, tema tjera specifike dhe sipas nevojës)	3	150	450	450	550
Total C			5,450	3,200	3,150
D - TRAJNIM & PËRGATITJA E STAFIT					
Trajnime të stafit	1	10,000	10,000	10,000	10,000
Të tjera			200	200	200
Total D			10,200	10,200	10,200
E - MEDIA – INVOLVIMI I MEDIAVE NË AKTIVITETE					
TV (lokale & qendrore)	5	50	250	350	400
Radio	5	30	150	250	300
Total E			400	600	700
Total: A+B+C+D+E			20,250	18,800	19,450

Duke pasur parasysh se KRU "Mitrovica" Sh.A., dita ditës po zgjerohet dhe po zgjeron edhe aktivitetet e saja, dhe me qëllim të fuqizimit të aktiviteteve të kësaj zyre, parashihet që kjo zyrë të plotësohet me staf shtesë, së paku një (1) person kur dihet fakti se kjo zyrë kryen punë të shumëllojshme të cilat në vete ngërthejnë shumë aspekte afariste të kompanisë. Marrja një punonjësi të ndikonte në kryerjen më të shpejtë dhe më efektive të punëve me ç' rast disa nga kërkesat e vazhdueshme dhe në rritje do të mund të zgjeroheshin edhe më tej.

7 PLANI I INVESTIMEVE

7.1 Lista e projekteve të planifikuara

Tabela 25 Investimet kapitale 2024

Investimet 2023	Vlera ne EUR
Eriertimi	
Administrata	70,000
Mirembajtja e objekteve	15,000
Riparimi I pusetave (betonimi I tyre)	58,000
Nderrimi I gypit te ujesjellesit ne Vushtrri -Slatine Rruga 7 Maj	140,000
Rrjet Emergjente (Sanimi I rrjetit ne Mitrovice- Iliride)	200,000
Ndarja ne Lushte- Skenderaj- Mitrovice	50,000
IT	60,000
Sistemet e Sigurise dhe mbrojtjes ne pune	35,000
Zevendesimi I pompave 15,000*10	150,000
Mirembajtja e rrjetit energjetik	50,000
Rivlersimi I aseteve	30,000
Investime ne rrjet	54,836
Marketing	10,000
Gjithsej	922,836

7.2 Draft Lista e Projekteve të Identifikuara në KRUM 2024 -2026

Tabela 26 Projektet e Identifikuara

PROJEKTI		FINANCUESI					Periudha e implementimit
	Përshkrimi	Vetënaqe	MZHE	BERZH, EIB, WIFB	Tiflera	Suport financiar/kuar	
1	P 052 Mitrovicë- Impianti i trajtimit të ujërave të zeza Mitrovicë-Vushtrri			€ 38,000,000		€ 38,000,000	2023-2027
2	P 059 Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Funjizimi dhe instalimi i sistemeve të sigurisë në rezervuarit e ujit, stacionet e pompave dhe fabrikat e ujit të kompanisë Rajonale të Ujësjellës Mitrovica		€ 186,201			€ 186,201	2024
3	P 058 Mitrovicë Ndërimi dhe montimi i pompave në stacionet e pompimit (Tuneli i Pare, Stanterg, Frasher dhe Koshtove)		€ 190,000			€ 190,000	2024
4	P 041 Mitrovicë - Ngritja e imolantëve Energjetike Fotovoltaike (IEPV)	€ 270,000	€ 200,000			€ 470,000	2024
5	P.029 Mitrovicë: Ndërimi i gypit të ujësjellës në rrugët: Ukshin Kovaqic, Mbretresha Teuta, Qazim Cimitli.	€ 223,085				€ 223,085	Maj 2025- Tetor 2026
6	P 056 Mitrovicë Skenderaj, Ndërimi i objekteve përcjellëse për Objektin administrativ në Suhodoll dhe Skenderaj (Depo dhe Garazha)		€ 270,000			€ 270,000	2024
7	P 057 - Vushtrri Ndërimi i Objekteve përcjellëse në Vushtrri (Depo dhe Garazha)		€ 85,000			€ 85,000	2024

		€	140,000	€	140,000	€	140,000	2024			
8	P.062 Vushtrri- Ndërrimi i gypit të ujësjellësit në Fsh. Sllatin dhe rrugën "2Maj"							2024			
9	P.040 Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Pajse për matje Gjeozozike,						16,900	Shtator 2024 Qershor 2025			
10	P.028 Mitrovicë: Ndërrimi i gypit të ujësjellësit Roka – Tunel i Parë	€	105,766				105,766	2025			
11	P.039 Vushtrri: Ndërrimi i gypit të ujësjellësit në rrugët: Krujes, Hamdi Gashi, Naip dhe Fatmire Pashtica, si dhe Arsim Muzaqi	€	164,507				164,507	2024-2025			
12	P.61 Vushtrri: Ndërrimi i gypit të ujësjellësit në fshatrat Akrashitcë dhe Dolak						452,885	2025 - 2026			
13	P.019 Mitrovicë- Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në Rrugët: "Mbretresha Teut,,	€					239,195	Qershor 2026			
14	P.21 Mitrovicë - Ndërrimi i rrjetit të Kanalizimit në rrugët "Selim Berisha", "Tafil Boletini"	€					32,000	Qershor 2025			
15	P.024 Mitrovicë -Mjete Pune - Blerja e tre Eskavatorëve, për nevoja të Operatives	€					300,000	Qershor 2024-25			
16	P.054- Blerja e tre automjeteve të tipit pikap për nevoja të Operativës	€	55,000				55,000	2024-2025			
17	P.029 Mitrovicë- Ilirida, Ndërrimi i rrjetit të Ujësjellësit Shaban Polluzha.	€	200,000				200,000	2024			
18	P.023 Skenderaj: Ndërrimi i gypit të ujësjellësit në Lajga 1 dhe 2 Rrugët "Ahmet Dëlla" dhe L2 "Pexhep Malaj" dhe 28 Nantori	€	295,907				295,907	2024 -2026			
	TOTALI	€	1,954,265	€	931,201	€	38,000,000	€	1,020,980	€	41,906,446.00

7.1 Draft Plan i Investimeve në 2024- 2026

ID e Projektit dhe Titulli:	P 052 Mitrovicë- Impianti I trajtimit të ujërave të zeza Mitrovicë- Vushtri
Afati kohor i përfundimit:	2023-2027
Vlera e përlogaritur:	€ 38,000,000
Burimi i financimit:	BERZH dhe EIB- WBIF
Përshkrimi:	Objekti kryesor i projektit "Trajtimi i ujërave të zeza në Mitrovicë - Vushtri" është që të përmirësojë ndjeshëm mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të zeza në qytetin e Mitrovicës dhe Vushtrisë. Kjo do të kontribuojë në mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore dhe të ujërave nëntokësore në zonën e projektit, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë

ID e Projektit dhe Titulli:	P 059 - Furnizimi dhe instalimi i sistemeve të sigurisë në rezervuar e ujit, satcionet e pompve dhe fabrikat e ujit të Kompanisë Rajonale të Ujesjellësit Mitrovica.
Afati kohor i përfundimit:	-Dhjetor 2024
Vlera e përlogaritur:	186,201.00 €
Burimi i financimit:	MzhE
Përshkrimi:	<p>Me qëllim të rritjes së sigurisë në objekteve tona të cilat bëjnë furnizimin e qytetareve me ujë këtë projekt e shohim si të rëndësishme se veçante dhe prioritet në realizimin e tij.</p> <p>Kamerë Bullet 4MP për përdorim të jashtëm minimum specifikat e mëposhtme të detyrueshme ose ekuivalente</p> <p>Kamera duhet të jetë me sensor minimum 1/1.8 ose 1/1.2" Progressive Scan CMOS apo ekuivalent</p> <p>Kamera duhet të mundësojë klasifikimin e synimeve njerëzore si dhe automjeteve bazuar në mësimin e thellë (deep learning).</p> <p>Kamera duhet të ketë mikrofon të integruar si dhe të përkrahë komunikimin e dyanshëm (two - way audio), si dhe të ketë të integruar ditë aktive dhe alarm me qëllim të paralajmërimit të ndërhyrësve të jashtëm.</p> <p>Kamera duhet të ketë portin Lan : 10/100Mbps</p> <p>Kamera duhet të ketë të integruar speaker minimum 2W ,</p> <p>Kamera duhet të ketë minimum 1 hyrje dhe 1 dalje audio si dhe 1 hyrje dhe 1 dalje për alarm maz 24 VDC</p> <p>Kamera duhet të ketë mundësinë e qasjes simultante minimum në 6 kanale,</p> <p>Kamera duhet të ketë minimum 60m dritën për natën.</p> <p>Te ketë port për vendosje të microSD/SDHC/SDXC card (256 GB), local storage and NAS (NFS, SMB/CIFS), ANR . Kamera duhet të ketë mundësinë e furnizimit përmes PoE 802.3af, Class 3 dhe përmes 12 VDC.</p> <p>Kamera duhet të jetë prej materialit Aluminit-it, duhet të jetë rezistente ndaj ujit dhe pluhurit sipas standarit IP67 (IEC 60529-2013) si dhe të punoj në temperature minimum -30 °C to 60 °C.</p>

ID e Projektit dhe Titulli:	P 058 - Mitrovica Nderrimi i pompave -
Afati kohor i përfundimit:	-Dhjetor 2024
Vlera e përlogaritur:	190,000.00 €
Burimi i financimit:	MZHE
Përshkrimi:	Pompat janë të vjetra dhe të amortizuara. Pompat duhet të jenë të ngjashme me ato aktuale, pra pompa horizontale dhe duhet të shtynë ujin në të njëjtën lartësi dhe të njëjtin kapacitet. Mund të ndryshoje vetëm numrin e rrotullimeve të motorëve elektrikë, por ato do të jenë ende pompa horizontale dhe shumëfazore.

ID e Projektit dhe Titulli:	P 041 Mitrovicë - Ngritja e impianteve Energjetike Fotovoltaike (IEFV)
Afati kohor i përfundimit:	2023
Vlera e përlogaritur:	470,000.00 €
Burimi i financimit:	Nuk është definuar ende
Përshkrimi:	Ngritja e impianteve Energjetike Fotovoltaike (IEFV) me kapacitet 840 kw ,i lidhur me rrjetin shpërndarës 0.4 kv ,e cila do të mbështet kërkesat për energji elektrike në dy impiantet e përpunimit të ujit të KRU Mitrovica , detyra e të cilit është reduktimi i kostos operative ,ritja e stabiliteti me furnizim me energji elektrike dhe reduktimi i emetimit të CO2 etj.

ID e Projektit dhe Titulli:	P.064 P.64 Mitrovicë: Nderrimi i gypit të ujësllësit në rrugët: Ukshin Kovaqica, Mbretresha Teuta, dhe Qazim Cimili-
Afati kohor i përfundimit:	Maj 2024– Tetor 2025
Vlera e përlogaritur:	€223,085
Burimi i financimit:	Vetanak
Përshkrimi:	Gypat ekzistuese AC dhe Zn të shtrirë shumë vite më parë është në gjendje shumë të rëndë. Qëllimi i këtij projekti është furnizimi me ujë i banorëve të katër rrugëve si dhe zvogëlimin i humbjeve të cilat ndodhin për shkak të rrjetit jo adekuat.

ID e Projektit dhe Titulli:	P 056 -Ndertimi i objekteve përcjellëse për Objektin administrative në Suhodoll dhe Skenderaj(Depo dhe Garazha)
Afati kohor i përfundimit:	2024
Vlera e përlogaritur:	€ 270,000
Burimi i financimit:	MZHE
Përshkrimi:	Ndërtimi i një Depoje qendrore për sistematizim të materialit pranë Administratës në Suhodoll me qëllim të evitimit të pagesës së qerasë, distancës së madhe nga Objekti kryesor si dhe siguria e materialeve, gjithashtu ndërtimi i garazheve për makinë të lehta dhe të rënda të Kompanisë. Finalizimi i punëve të mbetura (meremetuese) dhe ndërtimi i objekteve përcjellëse për Objektin Administrativ në Skenderaj .

ID e Projektit dhe Titulli:	P 057 Vushtrri -Ndërtimi i objekteve përcjellëse për Objektivin administrative në Vushtrri(Depo dhe Garazhe)
Afati kohor i përfundimit:	2023
Vlera e përlogaritur:	€85,000
Burimi i financimit:	MZHE
Përshkrimi:	Ndërtimi i një Depoje qendrore për sistematizim të materialit pranë Administratës në Vushtrri me qëllim të evitimit të pagesës së qerasë, distancës së madhe nga Objekti kryesor si dhe siguria e materialeve, gjithashtu ndërtimi i garazheve për makineritë të lehta dhe të rënda të Kompanisë.

ID e Projektit dhe Titulli:	P.062 Vushtrri: Ndërtimi i gypit të ujësjetës në 'rrugën "2 Maji"dhe në fshatin Sllatin.
Afati kohor i përfundimit:	Shtator 2024
Vlera e përlogaritur:	€140,000
Burimi i financimit:	Nuk është definuar ende
Përshkrimi:	Gypat ekzistuese AC dhe Zn të shtrirë shumë vite më parë është në gjendje shumë të rëndë. Qëllimi i këtij projekti është furnizimi me ujë i banorëve të ketyre rrugëve si dhe zvogëlimin i humbjeve të cilat ndodhin për shkak të rrethit jo adekuat.

ID e Projektit dhe Titulli:	P 040 Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri' "Paisje për matje Gjeodezike,,
Afati kohor i përfundimit:	Shtator 2024
Vlera e përlogaritur:	€ 16,900
Burimi i financimit:	Ministria e zhvillimit ekonomik
Përshkrimi:	Blerja e një pajisjeje për matje Gjeodezike digjitale GPS do të lehtësojë punën në terren për marrjen e informatave sakta dhe futjen e tyre në GIS.

ID e Projektit dhe Titulli:	P 028 Mitrovicë: Ndërtimi i gypit të ujësjetës Rekë – Tunel i Parë
Afati kohor i përfundimit:	- Dhjetor 2025 – 2026
Vlera e përlogaritur:	€ 605,766
Burimi i financimit:	Nuk është definuar ende
Përshkrimi:	Ndërtim i gypit AC 315 L= 2900m Qëllimi i projektit është zvogëlimi i humbjeve të ujit, gjegjësisht krijimi i kushteve për furnizim kualitativ me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët gjithashtu shërbimi me kualitativ dhe zvogëlim i humbjeve në mirëmbajtje.

ID e Projektit dhe Titulli:	P.039 Vushtrri: Ndërrimi i gypit të ujësjellësit në 'rugët, Kruja, Hamdi Gashi, Naip dhe Fatmire Pashtica, si dhe Arsim Muzaqi,
Afati kohor i përfundimit:	Maj 2024– Shtator 2025
Vlera e përlogaritur:	€ 164,507
Burimi i financimit:	Nuk është definuar ende
Përshkrimi:	Gypat ekzistuese AC dhe Zn të shtrirë shumë vite më parë është në gjendje shumë të rëndë. Qëllimi i këtij projekti është furnizimi me ujë i banorëve të katyre rrugëve si dhe zvogëlimin i humbjeve të cilat ndodhin për shkak të rrjetit jo adekuat.

ID e Projektit dhe Titulli:	P 029 Mitrovicë–Iirida, Ndërrimi i rrjetit të Ujësjellësit Rr; Shaban Polluzha, Ukshin Kovaqic, Mbretresha Teuta, Qazim Cimli
Afati kohor i përfundimit:	Qershor 2025 – 2026
Vlera e përlogaritur:	€ 223,085
Burimi i financimit:	Investime vetanake
Përshkrimi:	Iirida, Ndërrimi i rrjetit të Ujësjellësit rru: „Shaban Polluzha .Gypi ekzistues është AC etj DN 80 , duhet të zëvendësohet me DN 100PE. Qëllimi: Shërbimi me kualitativ dhe zvogëlim i humbjeve në mirëmbajtje janë edhe humbjet e ujit.

ID e Projektit dhe Titulli:	P.061 Vushtrri: Ndërrimi i gypit të ujësjellësit në F.sh Akrashtice dhe Dolak
Afati kohor i përfundimit:	Maj 2025– Shtator 2026
Vlera e përlogaritur:	€ 432,885
Burimi i financimit:	Nuk është definuar ende
Përshkrimi:	Gypat ekzistuese AC dhe Zn të shtrirë shumë vite më parë është në gjendje shumë të rëndë. Qëllimi i këtij projekti është furnizimi me ujë i banorëve të katyre rrugëve si dhe zvogëlimin i humbjeve të cilat ndodhin për shkak të rrjetit jo adekuat.

ID e Projektit dhe Titulli:	P021-Ndërrimi i rrjetit të Kanalizimit në rrugët "Selim Berisha", "Tafil Boletini"
Afati kohor i përfundimit:	Qershor 2026
Vlera e përlogaritur:	€32,300
Burimi i financimit:	Nuk është definuar ende

Përshkrimi:	Shkak i bllokimeve të shpeshta dhe dimensionim jo adekuat gjegjësisht kapacitete të pamjaftueshme të gypit për përfshirjen e të gjitha ujërave Rrugët: "Selim Berisha" L=350m, ø 300 Qender dhe "Tafil Boletini", L=250, ø 300. "Kolani"
--------------------	--

ID e Projektit dhe Titulli:	P 024 - Mitrovicë Mjete Pune - Blerja e tre Eskavatorëve, për nevoja te Operatives
Afati kohor i përfundimit:	Qershor 2024/25
Vlera e përllogaritur:	€ 300,000
Burimi i financimit:	Nuk është definuar ende
Përshkrimi:	Qëllimi i investimit është përmirësimi i shërbimeve të ujërave të zeza në Njësit Operative.

ID e Projektit dhe Titulli:	P 054 Mitrovicë- Blerja e tre automjeteve të tipit pikap për nevoja të Operativës
Afati kohor i përfundimit:	2024-2025
Vlera e përllogaritur:	€ 55,000
Burimi i financimit:	Investim Vetanak
Përshkrimi:	Qëllimi i investimit është përmirësimi i shërbimeve të arkëtimit ,teknikes dhe kontrollit si dhe shërbimeve tjera.

ID e Projektit dhe Titulli:	P 023 Skënderaj - Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugët: "Lagjja nr 1- "dhe L 2 ne Rr: 28 Ahmet Delia, dhe L,2 Rexhep Mala, dhe 28 Nentori
Afati kohor i përfundimit:	Nentor 2024 – 2025
Vlera e përllogaritur:	€295,907
Burimi i financimit:	Nuk është definuar ende
Përshkrimi:	Instalimi i gypave me diametër të ndryshëm shumë vite më parë është në gjendje shumë të rëndë. Qëllimi i këtij projekti është furnizimi me ujë i banorëve të ketyre rrugëve si dhe zvogëlimin i humbjeve të citat ndodhin për shkak të rrjetit jo adekuat.

ID e Projektit dhe Titulli:	P P 029 Mitrovicë-Ilirida, Ndërrimi i rrjetit të Ujësjellësit Shaban Polluzha.
Afati kohor i përfundimit:	Nëntor 2024
Vlera e përllogaritur:	€ 200,000

Burimi i financimit:	Investim Votanak
Përshkrimi:	Instalimi i gypave me diametër të ndryshëm shumë vite më parë është në gjendje shumë të rëndë. Qëllimi i këtij projekti është furnizimi me ujë i banorëve të këtyre rrugëve si dhe zvogëlimin i humbjeve të cilat ndodhin për shkak të rrjetit jo adekuat.

Lista e Projekteve Tjera te Identifikuara ne KRUM 2024-2026

PROJEKTI		
	Përshkrimi	Te tjera
<u>1</u>	P 031 Mitrovicë – Zëvendesim i rrjetit të ujësjellësit në Koloni	€ 75,265
<u>2</u>	P 032 Mitrovicë Ndërtimi i rrjetit të Kanalizim Sami Gashi dhe i rrugicave	€ 338,000
<u>3</u>	P 018 Mitrovicë- Ndërtimi i gypave të kanalizimit Rruga Qirimi , "Vellozerit Dragaj", "Dkshin Kovaqica " dhe "Ali Zeneli "	€ 101,065
<u>4</u>	P 026 Skenderaj Ndërtimi i rrjetit të Kanalizim Skenderaj - Klin e Eperme	€ 312,000
<u>5</u>	P 007 Vushtri- Ndërtimi i gypave të ujësjellësit STO ,, Mutfaja,, deri te rezervari ne Studime	€ 1,823,824
<u>6</u>	P 042 Mitrovicë - Ndërtimi i gypit nga Zn në PE ,në lagjen e Sitnicës.	€ 89,636
<u>7</u>	P 043 Mitrovicë - Ndërtimi i gypit nga Zn në PE ,në lagjen Bair.	€ 108,307
<u>8</u>	P 055 - Furnizimi me 2 kamion Kiper 5 tonësh	€ 64,000
TOTALI		2,912,097

7.1 Hyrje

KRU "Mitrovica" Sh.A. ka sistem funksional të GIS (Geographic Information System) dhe aplikon platformën ArcGIS Desktop Basic versioni 10.6. Është i instaluar nga viti 2018 me licencë të ArcMap, licenca është single use, projekt i cili është financuar nga Lux Dev. Që nga viti 2018 me sigurimin e licencës së Arc GIS, kemi filluar që të bëjmë digjitalizimin e rrjetit të ujit (primar dhe sekondar), me të dhëna teknike nga projektet e përfunduara dhe të pranuar teknikisht për tërë regjionin dhe të cilat janë dorëzuar në zyrën e sektorit të GIS-it, në kopje të fortë ose dixhitale si dhe në konsultim me Menaxherët e rrjetës së ujit të tri Njësive Operative, por që nuk janë me matje gjeodezike të verifikuara në teren (Google Earth Pro).

Gjatësia e rrjetit të ujit (primar dhe sekondar), të digjitalizuar në sistemin GIS gjerë me tani L= 1,417.35 km, nga gjatësia e rrjetit të ujësjellësit (primar dhe sekondar), L=1,651.96 km, e raportuar në ARRU nga Departamenti Teknik për vitin 2022, ndërsa kemi arritur të bëjmë digjitalizimin e aseteve: stacione të pompimit 36, rezervuar 58, valvule operuese 795 të hapura, 15 të mbyllura, valvula ajrimi 43, valvule të reduktimit të shtypjes 13, ujëmatës zonal 122, hidrant 55, defekte në rrjetin e ujit 271, pompa 80, ujëmatës në prodhim 5. Nga 46,877 konsumatorë të deklaruar nga Departamenti për konsumatorë për vitin 2022, janë të regjistruar në sistemin GIS në total 42,295 konsumatorë, dhe jemi duke vazhduar regjistrimin e të gjithë konsumatorëve në sistem.

Intervenimet apo defektet në rrjetin e ujit kemi filluar t'i regjistrojmë në sistemin GIS nga viti 2023, me të dhënat e marra nga terreni nga ekipi i Mirëmbajtjes dhe deri më tani kemi 271 defekte të regjistruara në sistemin GIS.

Gjithashtu këtë vit kemi filluar regjistrimin e të dhënave për rrjetin e ujërave të zeza (kanalizimit), dhe kemi arritur të bëjmë digjitalizimin e 209.327 km nga 282.201 km të deklaruar nga Departamenti Teknik në ARRU për vitin 2022, dhe 600 puseta të kanalizimit janë regjistruar në sistem.

Intervenimet apo defektet në rrjetin e ujërave të zeza kemi filluar t'i regjistrojmë në sistemin GIS nga viti 2023, me të dhënat e marra nga terreni nga ekipi i Mirëmbajtjes dhe kemi 208 defekte të regjistruara deri më tani.

7.2 Objektivat specifike për vitin 2024

1. Të vazhdojmë me digjitalizimin e tërë rrjetit të ujësjellësit (primar dhe sekondar), për tërë regionin që furnizojmë me ujë të pijshëm.
2. Të vazhdojmë të bëjmë digjitalizimin e të gjitha aseteve infrastrukturore dhe jo infrastrukturore me të dhënat teknike.
3. Ndërhyrjet në rrjet të ujësjellësit dhe rrjetin e ujërave të zeza (kanalizimit), të vazhdojmë ti regjistrojmë në sistemin GIS.
4. Të bëjmë regjistrimin e të gjithë konsumatorëve në sistemin GIS dhe ndërlidhen online me sistemin e Faturimit (Billing).
5. Të bëhet ndarja e të gjitha DMA - zonave në bashkëpunim me Departamentin Teknik.

7.3 Sfidat

1. Sigurimi i sistemit GIS të licencuar në Server.
2. Mungesa projekteve të përfunduara dhe të pranuara teknikisht.
3. Mungesa e një ekipi në teren për mbledhjen e të dhënave nga terreni.
4. Sigurimi i të dhënave të sakta për çdo konsumator në teren.

8.1 Hyrje

Duke u nisur nga fakti se ujë është produkt jetësor për jetën dhe shëndetin, është e rëndësishme që të gjithë ata të cilët janë të përfshirë në menaxhimin e ujit, burimeve të ujit dhe shëndetit publik të kenë një kuptim të çartë, qasje të drejtë dhe detyrim moral e ligjor që të veprojnë në drejtim të ofrimit të ujit cilësor i cili plotëson standardet e parapara për cilësinë e ujit për konsum njerëzor.

Sigurimi i ujit të pijshëm tani dhe në të ardhmen është objektivi kryesor dhe pjesë integrale e vizionit tonë. Shëndeti i popullatës sonë është mbi të gjitha prandaj ofrimi i ujit cilësor është pjesë përbërëse e shëndetit të përgjithshëm.

8.2 Cilësia e ujit

Monitorimi i përgjithshëm i procesit të trajtimit dhe cilësia e ujit të trajtuar në Impiantet për Trajtimin e Ujit (ITU), monitorohet në baza të rregullta përmes:

- Sistemi SCADA – online 24h,
- Analizave fiziko - kimikë
- Institutit Kombëtarë të Shëndetit Publik (IKSHP) – analizat bakteriologjike

8.3 SCADA

Shkurtesa "SCADA" në gjuhën angleze qëndron për "Supervisory Control and Data Acquisition". Në gjuhën shqipe kjo do të thotë: "Kontrolli Mbikëqyrës dhe Përvetësimi/mbledhja e të Dhënave".

SCADA, pra nënkupton një sistem të automatizuar kompjuterik, ku kontrolli, mbikëqyrja dhe manovrimi/manipulimi i proceseve bëhet nga dhoma operuese përmes operatori/ dispeçerit.

Operatori/dispeçeri kujdestar përmes dhomës operuese respektivisht sistemit SCADA monitoron këto procese, dhe jo vetëm:

- Hyrjen e ujit të papërpunuar ,
- Stacionin e pompimit (pompat sekuenciale) ,
- Nivelin e trubiditetit (turbullshmërisë) së ujit ,
- Sasinë e klorit në fazën e para klorinimit dhe/ose sasinë e ozonit (operimi me ozon) ,
- Nivelin e PH-së ,

- Sasinë e kimikateve në ujë: ferro klorurin dhe alumin-sulfatin ,
- Procesin e filtrimit dhe pastrimit të fushave filtruese ,
- Sasinë e klorit në proces: klorimi kryesor ,
- Nivelin e ujit në rezervuarët kryesor ,
- Nivelin e rezervave të kimikateve në tanke ,
- Sasinë e prodhuar të ozonit ,
- Sasinë e ujit për riciklim (nga pastrimi i filtrave) ,
- Sasinë e ujit i cili del nga procesi i trajtimit për shpërndarje .

Vlen të ceket se sistemi SCADA evidenton dhe alarmon për çdo anomali/parregullsi që ndodh në cilëndo pjesë të procesit.

8.4 Analizat fiziko-kimike

Në laboratorët e ITU-ve të KRU, "Mitrovica" bëhen analizat fiziko-kimike të ujit të pa trajtuar dhe ujit të trajtuar por jo ato bakteriologjike. Këto analiza bëhen çdo 4 orë, që do të thotë 6 herë brenda 24 orëve.

Në këto analiza përfshihen:

- Era, shija, turbiditeti, ngjyra, shkalla Co-Pt, vlera e PH, shpenzimi i $Kmno_4$, klori i lirë, kloruret, amoniaku, nitritet, nitratet, hekuri, mangani, alumini dhe përçueshmëria elektrike.

Të gjitha analizat e punuara në laboratorët e ITU-ve janë brenda kufijve të lejuar për ujë dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor.

Edhe pse laboratori ynë është i pajisur me aparaturë për përcaktimin e disa parametrave të nevojshëm bakteriologjik, në mungesë të personelit adekuat (mikrobiologut apo kimistit të diplomuar), pjesa e parametrave bakteriologjik nuk është punuar në laboratorët tona.

8.5 Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik, dega në Mitrovicë, përcjell dhe monitoron cilësinë e ujit të pijes nga ana bakteriologjike përmes analizave të cilat i zhvillon përmes marrjes së mostrave në lokacione të ndryshme. IKSHP në bazë të rregullt mujore raporton tek ne, ndërsa në rast të ndonjë analize të dyshimtë IKSHP përsëritë mostrën e caktuar dhe na njofton për gjendjen reale të cilësisë së ujit.

8.6 Burimet e ujit

Duke pasur parasysh faktin se KRU "Mitrovica" Sh.A. furnizohet me ujë të papërpunuar nga "Ibër Lepenci", mbrojtja e burimeve të ujit është në kompetencën e tyre. Sidoqoftë, kompania është vigjlente dhe kujdeset që të monitoroj situatën e pjesës ku bëhet kaptimi i ujit në fshatin Lushtë dhe Balinc. Nga ana tjetër jemi në përpjekje që të sigurojmë objektet tjera përcjellëse si: rezervarët e ujit, stacionet e pompimit etj, duke siguruar rrethoja mbrojtëse përreth me qëllim të parandalimit të depërtimit të kafshëve në zonën mbrojtëse të tyre.

9 SHTOJCAT:

Caqet kryesore të performancës:

Të Dhënat dhe Caqet Kryesore të Përfomancës	Aktuale dhe e planifikuar	Planifikimi i Performancës në 2024-26		
	2023	2024	2025	2026
D 001 Uji i prodhuar (m3)	25,500,000	23,500,000	23,500,000	22,500,000
D 002 Konsumatorët e regjistruar (të faturuar) (nr.)	48,614	50,100	51,000	51,900
D 002.1 Konsumatorët shtëpiak (nr.)	44,737	46,092	46,920	47,748
D 002.1.1 Konsumatorët shtëpiak me ujëmatje (nr.)				
D 002.2 Konsumatorët kom. (biznese) (nr.)	3,552	3,507	3,570	3,633
D 002.2.1 Konsumatorët kom. (biznese) me ujëmatje (nr.)				
D 002.3 Konsumatorët kom. (institucione) (nr.)	325	501	510	519
D 002.3.1 Konsumatorët kom. (institucione) me ujëmatje (nr.)				
D 004 Uji me shumicë i faturuar (m3)	4,883,783	4,800,000	4,800,000	4,800,000
D 005 Uji i faturuar (m3)	7,772,284	8,007,829	8,167,985	8,167,985
D 005.1 Uji i faturuar (amviseri) (m3)	6,432,220	6,500,643	6,630,656	6,630,656
D 005.2 Uji i faturuar (biznese) (m3)	666,507	770,386	785,793	785,793
D 005.2.1 Uji i faturuar për konsumat, me ujëmatësë (biznese) (m3)		0	0	0
D 005.3 Uji i faturuar (Institucione) (m3)	673,557	736,800	751,536	751,536
D 005.3.1 Uji i faturuar për konsumat, me ujëmatësë (institucione) (m3)		0	0	0
D 006 Faturimi (€)	5,356,514	5,505,999	5,616,119	5,672,280
D 006.1 Faturimi për amviseri (€)	3,479,491	3,516,198	3,586,522	3,622,387
D 006.2 Faturimi për biznese (€)	602,427	682,073	695,714	702,671
D 006.3 Faturimi për institucione (€)	377,829	426,449	434,978	439,327
D 006.3 Faturimi nga uji me shumicë (€)	896,766	881,280	881,280	890,091
D 007 Arkëtimi (€)	4,524,066	4,922,326	5,069,996	5,222,096
D 007.1 Arkëtimi për amviseri (€)	3,519,425	3,813,805	3,928,219	4,045,066
D 007.2 Arkëtimi për biznese (€)	644,519	682,073	702,535	723,611

D 007.3 Arkëtimi për Institucione (€)	360,122	426,449	439,242	452,419
D 007.3 Arkëtimi nga uji me shumicë (€)	0	0	0	0
D 008 Të hyrat nga kyqjet	93,483	99,000	91,000	91,500
D 009 Shpenzimet operative pa amortizim	3,973,473	4,089,490	4,155,156	4,073,314
D 010 Shpenzimet jo operative (Investimet vetanake)	-	922,836		
D 011 Numri i punëtorëve	259	270	270	285
I 001 Uji i pafaturuar (%)	50%	45%	45%	43%

Performanca sipas njësive për vitin 2024

Pershkrimi	Mitrovica	Vushtrri	Skenderaj	Mitrovica e Veriut dhe Zveçan	Total
Prodhimi m ³	9,300,000	6,760,000	2,640,000	4,800,000	23,500,000
Faturimi m ³	3,862,822	3,058,007	1,087,000	4,800,000	12,807,829
Faturimi nga uji €	2,277,540	1,691,048	656,131	881,280	5,505,999
Faturimi- te tjera €	54,000	27,000	9,000		90,000
Faturimi Total €	2,331,540	1,718,048	665,131	881,280	5,595,999
Inkasimi nga uji €	2,430,701	1,786,522	705,103		4,922,326
Inkasimi - te tjera €	54,000	27,000	9,000		90,000
Inkasimi Total €	2,484,701	1,813,522	714,103	0	5,012,326
Nr. i Konsumatorëve	22,796	18,287	9,014	4	50,100
% e Inkasimit	107%	106%	107%	0%	89%
Shpenzimet	2,336,643	1,194,391	558,456	0	4,089,490
Pagat	1,255,798	732,081	423,566		2,411,444
Rryma elektrike	484,928	187,394	27,677		700,000
Shpe. e derivateve	17,362	12,153	5,485		35,000
Mirëmb. Dhe riparimet	48,095	7,967	3,938		60,000
Kemikalet	82,939	52,425	14,636		150,000
Shp. - Iber Lepenci	296,656	130,993	52,351		480,000
Shpenzimet tjera	150,865	71,378	30,802		253,046

<i>Uji i pafaturuar në m3</i>	5,437,178	-3,701,093	1,353,000	0	10,692,171
<i>Uji i pafaturuar në %</i>	58%	55%	59%	0%	45%
<i>Mbullimi operativ</i>	106%	152%	128%		123%

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----